

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7371 E shtunë 2 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Kur Kim Jong Un para katër vjetësh deklaroi se programi i tij i raketave do të përfundojë deri në fund të vitit 2017, askush nuk dëgjonte. "I cmenduri" ...
Vijon në faqen 12

Nga JURGEN HANEFELD
Koreja e Veriut do të jetë fuqi atomike
Vijon në faqen 12

Opinion i Ditës
Arsimi ynë po përjeton fazën e tretë të reformimit. Në këtë proces po pohojmë shumëçka me dëshirën për të ndryshuar, por duket kjo nuk mjafton. Nuk mjafton, jo pse ...
Vijon në faqen 21

Nga PËLLUMB KARAMETA
Ata që nxënë do trashëgojnë botën
Vijon në faqen 21



Reshjet intensive, tani rrezikohet jugu

Përmbytjet, Edi Rama: Falënderoj kreun e PD, Basha tregoi mirëkuptim

Dëmet në autostradë, prokurori: Regjistrojmë procedim penal dhe do verifikojmë problemet

Kryeministri Edi Rama së bashku me ministren e Mbrojtjes, Olta Xhaxhë dhe ministrin e Bujqësisë, Niko Peleshi inspektuan dje paradite zonën e Mifolit pranë Vlorës, një nga zonat me rrezikshmëri të shtuar për shkak të prurjeve të shtuara të lumit Vjosa. Ai u bëri thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë me strukturat ...
Në faqen 2-6

EMRAT/ 1 MIJE TRASHËGIMTARËT QË MARRIN KESTIN E PARË TË LEKËVE

TE PERNDJEKURIT, KUSH PERFITON DEMSHPERBLIM

Ministria e Financave: Dokumentet duhet të dorëzohen javën e ardhshme. Fëmijët, nipërit e mbesat e ish-të dënuarve që do të plotësojnë dosjet



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë

Në faqen 9-11


BLUE TROOP Bora Zemani, a u nda nga bashkëshorti? Ada Deda: Nuk e sakrifikoj nderin për çmime

Krizë dhe sherr, Tuna ndahet nga Patris Berisha

Këngëtarja e njohur braktis Prishtinën, kthehet në Shkup bashkë me të voglin Tian

Nga PAMELA ALIAJ
Gati një vit pasi u bë publike historia e dashurisë me Patris Berishën, çifti duket se i ka dhënë fund. Bëhet me dije se Tuna dhe partneri saj prej disa ditësh nuk janë më bashkë. Fillimisht dyshimet u shtuan pasi

çifti nuk ndiqte më në rrjetet sociale njëri-tjetrin. Mediat kosovare nisën aludimet rreth një ftohjeje mes dyshes së famshme, por duket se kriza mes të dyve ka qenë më e madhe. "Bluetooth" ka mundur të mësojë se tashmë Tuna ka lënë shtëpinë ku jetonte bashkë me Patrisin



në Prishtinë për t'u shpërngulur në Shkup, qytetin ku dhe jetonte para se të niste lidhjen me instrumentistin simpatik. Me aq sa kemi mundur të mësojmë mes çiftit ka pasur një debat, që duket se ka përfunduar me largimin ...
Suplement

Në faqen 22

BANKA BOTËRORE

Shqiptarët dhanë 325 milionë euro nga xhepi nëpër spitale

Në faqen 8

DEBATI NE KUVEND

Financimet, PD: Jo nga burime të errëta. PS: E nisim me lobimet

Në faqen 7

HIDHET SHORTI

Botërori 2018, Spanja përballë Portugalisë. Mesi në "grup ferri"

Në faqen 22

ARTIZANET

Endri Dani, ekspozita e një artisti në Milano

Në faqen 20

MOTI I KEQ PERMBYTJET

Ankesat e banorëve, ministri i Brendshëm inspekton nga afër të përmbyturit

Përmbytjet Tiranë-Durrës, prokurori: Shkak, dëmtimi i kanaleve kulluese

"Pritet të nisin hetimet, banorët të denoncojnë rastet"

Ina Allkanjari

TIRANË

Prokuroria e Tiranës pritet të nisë hetimet pas përmbytjeve të mbrëmjes së enjte në autostradën Durrës-Tiranë. Prokurori Ervin Karanxha paralajmëroi dje se organi i akuzës do kryejë hetime për ndërtimet pa leje pranë autostradës. Gjithashtu, prokurori ngre dyshime se shkak i përmbytjeve ka qenë dëmtimi i kanaleve kulluese në këtë aks. "Do verifikohet nëse ka apo jo elementë të veprës penale që shkaktojnë përmbytjet. Do verifikohen ndërtimet pa leje, bizneset dhe bllokimi i kanaleve kulluese. Kemi marrë denoncimet e bizneseve dhe banorëve, po bëjmë verifikimet tona. Sigurisht që do jenë objekt i hetimeve edhe palmat, por këtu ku ka ndodhur kjo nuk shohim ndonjë palme. Qytetarët, nëse kanë pretendime, të bëjnë kallëzimin në prokurorinë e Tiranës", tha prokurori Karanxha. Ndërkohë Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj për shkak të situatës problematike në autostradën Tiranë-Durrës, prej reshjeve të shumta, ka shkuar në terren për të parë nga afër gjendjen. Xhafaj ka diskutuar me banorët, të cilët kanë shprehur pakënaqësi të shumta.

PËRPLASJA E XHAFAJT ME BANORËT

Përmbytjet masive në autostradën Tiranë-Durrës kanë revoltuar banorët e zonës. Ministri i Brendshëm në një diskutim me qytetarët në autostradën Tiranë-Durrës, njoftoi për masat e marra për të përballur këtë situatë. "Policët i kemi të gjithë në dispozicion. Mund të them një fakt që e gjithë policia është në situatë të jashtëzakonshme. Që nga mbrëmja e djeshme e gjithë policia është në krye të detyrës. Ju i keni ndjekur, i



Prokuroria e Tiranës

Ministri



FATMIR XHAFAJ

Ministri i Brendshëm në një diskutim me qytetarët në autostradën Tiranë-Durrës, njoftoi për masat e marra për të përballur situatën. "Policët i kemi të gjithë në dispozicion. Mund të them një fakt që e gjithë policia është në situatë të jashtëzakonshme. Që nga mbrëmja e djeshme, e gjithë policia është në krye të detyrës.

ka dhënë dhe televizioni juaj. Me këtë rast, kjo është shumë e rëndësishme, dua t'ju falënderoj edhe për të gjithë këtë sakrificë që keni bërë ju, sepse është shumë e rëndësishme në radhë të parë për qytetarët për t'u përshtatur me këtë situatë, e për të ndjekur rregullat përkatëse. E dyta, është një ndihmë shumë e madhe dhe për ne që e menaxhojmë këtë situatë", është shprehur Xhafaj.

Ndërkohë banorët kanë shprehur pakënaqësi në përballjen me ministrin e Brendshëm Fatmir Xhafaj pasi e shohin situatën pa rrugëzgjdhje. "Ju kërkoni taksa dreqi e mori, po tani

ca do bëjmë ne, është shprehur një prej banorëve". Ndërsa, një tregtar tha se: "Ne jemi të pashpresë, ne jemi biznesmenë, ne jemi kuajt e ekonomisë, pa ne nuk ecën qerrja. Për këtë me vjen keq". Pas reagueve të qytetarëve Xhafaj është shprehur i gatshëm që të ofrojë ndihmën e tij. Ministri i Brendshëm në përballjen me banorët ka theksuar se ai është pjesë e qeverisë, e shtetit, dhe e ka për detyrim t'i shërbejë qytetarëve. Ndërkohë gjatë diskutimit me qytetarët një banor pohoi para ministrit se shtëpia e tij ishte përmbytur 7 herë dhe se ndërrohet nga vit mobiliet. Teksa anko-

HETIMI

Prokurori Ervin Karanxha paralajmëroi dje se organi i akuzës do kryejë hetime për ndërtimet pa leje pranë autostradës dhe për mbjelljen e palmave. Gjithashtu, dyshohet se shkak i përmbytjeve ka qenë dëmtimi i kanaleve kulluese në këtë aks.

hej i riu është përlotur, për këtë situatë Xhafaj i ka premtuar zgjidhje dhe i ka dhënë një numër telefoni ku mund ta kontaktoje. Për sa i përket makinave të dëmtuara ministri Xhafaj u shpreh se janë vënë në dispozicion karroret që të normalizohet situata dhe të zhblokohen rrugët. "Ne kemi vënë në dispozicion karroret, ato mundësi që kemi, që t'i lëvizim. Kemi biseduar dhe me drejtorin dhe shefin e qarkullimit që, së pari, njëherë të jemi shumë të kujdesshëm, që të paktën ato që i ka dëmtuar natyra, mos të dëmtohen nga faktorët e tjerë të jashtëm dhe të jenë në prezencë vetë drejtuesit e mjeteve mundësisht. Edhe kur nuk janë në prezencë, të ketë mundësi policia, nëpërmjet karroretëve, t'i sistemojë diku, për të vazhduar pastaj. Dhe dy gjëra, fillimisht mjeti të ruhet aq sa mund të ruhen në këtë situatë dhe e dyta, që është shumë e rëndësishme, të normalizohet situata". Për sa i përket zhblokimit të rrugës dhe kalimit në autostradën Tiranë-Durrës, Xhafaj tha se nuk mund të japë një përgjigje se kur mund të zhblokohet, por është e rëndësishme të lirohet nga mjetet.



Përmbytjet në autostradën Tiranë-Durrës

REAGIMET

Banorët kanë shprehur pakënaqësi në përballjen me ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj, pasi e shohin situatën pa rrugëzgjdhje. "Ju kërkoni taksa dreqi e mori, po tani ç'do bëjmë ne", është shprehur një prej banorëve. Ndërsa, një tregtar tha se: "Ne jemi të pashpresë, ne jemi biznesmenë, ne jemi kuajt e ekonomisë, pa ne nuk ecën qerrja".



Vidhnin banesat në Kamëz, bien në pranga dy të rinj, tre të tjerë në kërkim

TIRANË-Policia e Tiranës vijon përpjekjen për goditjen e grupeve kriminale, ku në kuadër të operacionit të koduar "Stuhia", kanë rënë në pranga dy persona dhe tre të tjerë janë shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për rastet e grabitjes së banesave në Kamëz, ku u bë i mundur arrestimi i shtetasve Ardit Elezi, 21 vjeç dhe Adrian Prela, 19 vjeç; të dy banues në Kamëz. Gjithashtu, janë shpallur në kërkim bashkëpunëtorët, shtetasit M. Gj., 34 vjeç, banues në Valias, Kamëz, i dënuar më parë për veprën penale "Drejtim mjeti pa dëshmi"; L. E., 28 vjeç, banues në Kamëz; D. T., 22 vjeç, banues në Valias, Kamëz. Këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin vidhnin sende të ndryshme, goma automjeteve me gjithë disqe, vegla pune dhe i shisnin ato në treg me qëllim përfitimit vlerash monetare. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasve Ardit Elezi dhe L. E., janë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale sende të ndryshme dhe i sekuestruan në cilësinë e provave materiale mjete: një armë zjarri pistoletë tip "BERETTA"; 4 fishekë model 7.65; 2 maska; 2 palë doreza; 1 palë gërsërë dry prerës; 1 xhup lëkure me ngjyrë të zezë; 1 palë tuta me ngjyrë blu të errët me viza të bardha, të cilat i përdornin për realizimin e veprave penale. Bëhet me dije se në vijim të veprimeve hetimore rezultoi se shtetasit L. E., dhe D. T., janë bashkautorë të ngjarjes të ndodhur më datë 06.11.2017, në rrugën "Bulevardi Blu", ku dy persona të paidentifikuar nën kërcënimin e armës së dyshuar kanë tentuar të vjedhin kasafortën e një karburanti.



DEMET NE VALIAS

Dhjetëra banesa në fshatin Valias të Bashkisë Kamzë, janë mbuluar nga uji, e përveç dëmtimeve të shumta materiale brenda në shtëpi, janë prekur edhe bagëtitë e banorëve. Ndërkohë banorët e revoltuar bëjnë me dije se për orë të tëra kanë kërkuar ndihmë nga bashkia e policia, por askush nuk i është përgjigjur thirrjes së tyre.

Stakohet impianti i Bovillës, spitalet furnizohen me 20 bote nga UKT

TIRANË. Reshjet e dendura që kanë përfshirë Tiranën, kanë shkaktuar turbullirë në liqenin e Bovillës, duke krijuar një situatë kritike në impiantin e përpunimit të ujit e për rrjedhojë në furnizimin me ujë për një pjesë të qytetit. Impianti i përpunimit të ujit të liqenit të Bovillës është stakuar ditën e djeshme e UKT po përpiqet të shfrytëzojë çdo burim të mundshëm alternativ konkretisht burimet e Shën Mërisë, Selitës, Bërullit dhe Laknasit, për furnizimin e banorëve të Tiranës me ujë të pijshëm, deri në përmirësimin e situatës në Bovillë. Bashkia e Tiranës dhe UKT u bën thirrje të gjithë qytetarëve të saj të tregohen të kujdesshëm me përdorimin e ujit të pijshëm gjatë orëve në vijim, derisa turbullira e shkaktuar nga prurja e madhe e rrjedhjeve në liqenin e Bovillës të pastrohet dhe impianti të kthehet në punë në kapacitet të plotë. Ndërkaq, UKT ka marrë të gjitha masat, duke furnizuar me bote në mënyrë të pandërprerë të gjitha institucionet e rëndësishme së veçantë sidomos spitalet, maternitetet, azilet dhe konviktet. UKT ka në dispozicion 20 bote që furnizohen vazhdimisht me ujë të pijshëm dhe shpërndahen në mënyrë të organizuar. Ditën e djeshme janë kryer mbi 50 furnizime me ujë në QSUT, Spitalin Ushtrake dhe maternitetet, duke bërë të mundur që të gjitha këto institucione të mos e ndjejnë në mënyrë absolute reduktimin e furnizimit me ujë. Me tej, Ujësjellës-Kanalizime Tiranë ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të përdorin me kujdes dhe të kursejnë ujin deri në kapërcimin e situatës emergjente të shkaktuar nga kushtet atmosferike.



**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PERGJITHSHMË E PERMBARIMIT
ZYRA PERMBARIMORË TIRANË**

Zyra e Permbarimit Tirane me permbareus gjyqesor Albert Fejzo, ne baze te vendimit nr. 10484, date 30.11.2017, shpalli shlyjen ne ankand te pasurise apartamentin te banimit me siperfaqe 57 m2 te ndodhur ne Rrugen: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 ne Zonen kadastrale 8260 le regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurise Palatjshme Tirane me nr pasurie nr 2/54-4-60, volumi 6, faqe 82 Tirane, ne vleren duke filluar nga 2.800.000 (dy milion e teteteind mijë) Lekë.

Ankandi zhvillohet me ambientet e Zyres te Permbarimit Tirane, ne adresen: Sheshi Mustafa Ataturk, Kryeqyteti "21 Dhjetori", Tirane dite e Premte, me date 15.12.2017, ora 16.00.

Mbledhja e Ramës me ministrat, masat e marra për përbalimin e situatës

Moti i keq, evakuohen 177 familje, shpëtohen 226 persona

Dëme materiale në banesa, shkolla e biznese

Voltiza Duro

Moti i përkeqësuar dhe reshjet e den dura të shiut këto dy ditët e fundit, kanë "mposhtur" gjithë vendin e kanë shkaktuar dëme të mëdha materiale. Plot 177 familje janë evakuuar e 266 persona janë shpëtuar, ndërkohë që në rang vendi, rezultojnë deri më tani 3300 banesa e 23 shkolla të dëmtuara. Këto të dhëna janë publikuar pasditën e ditës së djeshme nga Komiteti i Koordinimit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile gjatë mbledhjes së drejtuar nga kryeministri i vendit, Edi Rama ku është bërë një shprehim i situatës së përgjithshme nga përmblytjet që kanë kapluar mbarë vendin. Të gjithë ministrat kanë dhënë informacion për gjendjen dhe kanë treguar masat që janë marrë deri më tani për përbalimin e situatës. Ndërkohë Rama replikoi akuzat për përmblytjen e autostradës për shkak të palmave, që bllokuan kanalizimet dhe theksoi se pritet një situatë aspak e lehtë sidomos në jugun e vendit. "Njësitë logjistike janë të pa mjaftueshme përballë tërbimit të natyrës. Ne sot jemi të mirëorganizuar dhe duhet të vazhdojmë në çdo orë të bëjmë detyrat tona", u shpreh kryeministri. Këshilltari i kryeministrit për mbrojtjen, Sandër Lleshi u shpreh se këto janë reshjet më të mëdha e bëri thirrje se në tri ditët në vijim do të ketë prurje të larta në lumin Vjosë.

QARKU I TIRANËS

Dy ditët e fundit janë shqëruar me përmblytje e dëme të shumta materiale edhe në qarkun e Tiranës, ndërkohë që banorët apelojnë për ndihmë nga instancat përkatëse. Pas 20 orësh, autostrada Tiranë-Durrës u zhblokua duke lënë pas dëme miliona euro për bizneset aty afër. Me dhjetëra biznese përgjatë autostradës Tiranë-Durrës janë dëmtuar rëndë nga përmblytjet e ndodhura përgjatë mbremjes së të enjtes. Ata shprehën se kanë pësuar dëme që shkojnë deri në disa milionë euro, ndërsa godinat kanë dalë pothuajse jashtë funksionit. Në Kamzë, situata është paraqitur tejte mërgjente, pasi nga përmblytjet janë prekur plot 463 familje. Përmblytjet kanë



Komiteti i Koordinimit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile

krijuar një situatë tejet të rënduar në disa zona të kësaj bashkie, si Valias, Frutikuturë, Laknas, Bathore, Kamzë, Paskuqan1, Paskuqan 2, Kamzë, Fushë-Kërçik, etj. Dhjetëra banesa në fshatin Valias të Bashkisë Kamzë, janë mbuluar nga uji, e përveç dëmtimeve të shumta materiale brenda në shtëpi, janë prekur edhe bagëtitë e banorëve. Ndërkohë banorët e revoltuar bëjnë me dije se

per orë të tëra kanë kërkuar ndihmë nga bashkia e policia, por askush nuk i është përgjigjur thirrjes së tyre, në një kohë që mobiliet e tyre po lundrojnë në ujë e çdo gjë është bllokuar. Ndërkaq, mbi 30 familje janë përmblytur në fshatin Bregu i Shkozës, pjesë e Bashkisë së Vorës. Me tej, mbremjen e së enjtes, reshjet e shiut kanë shkaktuar rrëshqitje dherash në rrugën Tiranë-Ndroq. Për të normalizuar situatën, disa mjete të rënda kanë punuar gjithë paraditen e ditës së djeshme për të larguar dherat e rënë në rrugë që bllokuan qarkullimin e autotjeteve për orë të tëra.

MSHMS aktivizon planin e emergjencës

Shërbimet 24-orëshe, në gatishmëri qendrat shëndetësore

Është zgjeruar shërbimi 24 orësh për qendrat shëndetësore në të gjitha ato zona që përbëjnë emergjencë për shkak të përmblytjeve. Në orët e vona të pasdites së djeshme, ka nisur funksionimi i qendrave të tilla në qarkun e Fierit, respektivisht qendrat shëndetësore Frakull, Mbrostar, Topojë, Levan, Derven si dhe qendra shëndetësore në Bashkinë Roskovec dhe Strumë, ku janë në gatishmëri plot 32 mjekë, 113 infermierë dhe 7 ndihmës epidemiologë. Gjithashtu, ky shërbim 24 orësh në qendrat shën-

detësore do të vihet në shërbim të qytetarëve edhe në qarkun e Gjirokastrës e Vlorës. Ndërkaq, njësi e helikopterëve vijon të jetë në gatishmëri të plotë për çdo rast emergjent. Ministria e Shëndetësisë ka aktivizuar planin e emergjencës, duke garantuar shtim të kapaciteteve në rast nevojë për të përbaluar një rritje të ngjarjeve të tjera që kanë lidhje me situatën e krijuar; sigurimin e barnave dhe materialeve mjekësore për çdo fluks potencial emergjencë; sigurimin e energjisë, ujit dhe ngrohjes së spitaleve.

NJOFTIMI I PERGJITHSHEM PROKURIMI

Shërbimi: Shqipëri
Projekti: Projekti i Mikrofinansancës në Shqipëri
Sektori: Mikrofinansancë
Mënyra e financimit: *Hua e IDB (ALB 0030), Hua e ISFD(ALB 0031) dhe Granti i Asistencës Teknike (ALB 0032)*

Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF Sh.a ka marrë financim në shumën prej 5.30 milion USD, ekuivalent nga Banka Islamike për Zhvillim, në drejtim të kostos së Projektit Mikrofinanciar në Shqipëri dhe ka për qëllim të zbatojë një pjesë të ardhurave për pagesat për mallrat , punimet, shërbimet e lidhura dhe shërbimet e konsulencës që do të prokurohen në kuadër të këtij projekti. Ky projekt do të financohet bashkarisht nga Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit FAF Sh.a.

Projekti do të përfshijë komponentët e mëposhtëm:

- I. Skema e Mikrofinansancës
- II. Ngrija e Kapaciteteve dhe Trajnime
- III. Auditimi Financiar
- IV. Vlerësimi i mikrofinansancës
- V. Hulumtimi i vlerësimit bazë / afatmesëm / përfundimtar

Prokurimi i kontratave të financuara nga Banka Islamike për Zhvillim do të bëhet përmes procedurave të përcaktuara në Udhëzimet për Prokurimin e Mallrave dhe Punimeve sipas financimit të Bankës Islamike të Zhvillimit (edicioni aktual) dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar siç përcaktohet në udhëzim.

Njvitet specifike të prokurimit për kontratat do të ofrohen sipas procedurave kombëtare të blerjeve. Parakualifikimi i furnizuesve dhe kontraktorëve do të kërkohet për kontratat e mëposhtme:

- I. Sistemi Qëndror i Bankës "MIS"

MOTI I KEQ PERMBYTJET

Forcat e Policisë së Shtetit, zjarrfikëset dhe ushtria në ndihmë të banorëve të prekur

Prenci: Situata problematike, priten përmbytje si të 2015

"Do ketë edhe evakuime me forcë, zbatoni rregullat"

Reshjet e dendura dhe përmbytjet në zona të ndryshme në Tiranë kanë sjellë reagimin e emergjencave civile, të cilat kanë dhënë informacione për situatën aktuale të vendit. Shemi Prençi, kreu i Emergjencave Civile, u shpreh dje se situata ka qenë më problematike në Tiranë, në aksin rrugor Vorë-Tiranë dhe në aksin Vorë-Thumanë. Gjithashtu, pritet një përqendrim i situatës në juglindje dhe verilindje duke e krahasuar situatën të ngjashme me atë të vitit 2015. "Në të gjithë territorin e vendit ka pasur reshje, dhe situata ka qenë më problematike në Tiranë, në aksin rrugor Vorë-Tiranë dhe në aksin Vorë-Thumanë. Ka pasur prezencë uji edhe në aksin Gjirokastër-Thumanë. Ka pasur probleme në aksin rrugor Vorë-Thumanë, pasi kishte prezencë uji deri në dy metra në disa biznese. Strukturat kanë qenë në ndihmë të qytetarëve. Një pjesë e qytetarëve nuk kanë respektuar edhe thirrjen për të evituar lëvizjet. Pritet të përqendrohet situata në rajonin juglindor dhe mund të kemi përmbytje si në vitin 2015. Banorët që janë kërcënuar nga përmbytjet në vitin 2015 duhet të lënë banesat ose të strehohen në katet



Shemi Prençi, kreu i Emergjencave Civile

e dita. Do ketë edhe evakuime me forcë, nëse nuk zbatohen rregullat. Aksi rrugor i Thumanës duhet të evitohet. Bizneset duhet të ndërpresin aktivitetin në akset rrugore që mos bëhen pengesë"- tha Shemi Prençi. Gjithashtu, bëhet me dije se Drejtoria e Emergjencave Civile po ndjek nga afër situatën. Për t'u ardhur në ndihmë banorëve të prekur nga përmbytjet janë angazhuar forca të Policisë së Shtetit, Zjarrfikësve dhe Ushtrisë.

QARKU TIRANË

Aksi rrugor Tiranë-Durrës, në Kashar, në afërsi të qendrës tregtare "City Park" mëngjes-

in e djeshëm ka rezultuar i bllokuar nga prezencja e ujit. Në vendngjarje kanë shkuar Policia Rrugore, Tiranë për zhblokimin e trafikut dhe 3 automjete zjarrfikëse me 3 motopompa për largimin e ujit. Bëhet me dije se në ndihmë kanë shkuar edhe 20 forca të ushtrisë me motobarka, 12 forca të ushtrisë me 4 pompa thithëse me kapacitet të lartë, 10 forca të FNSH-së nga Reparti 731, Shkodër, të cilët kanë evakuuar rreth 200 persona. Në qendrën tregtare "City Park" janë evakuuar rreth 100 persona, të cilët ishin bllokuar nga prezencja e ujit. Ndërkohë në fshatin

QENDRA TREGTARE

Aksi rrugor Tiranë-Durrës, në Kashar, në afërsi të qendrës tregtare "City Park", mëngjesin e djeshëm ka rezultuar i bllokuar nga prezencja e ujit. Në vendngjarje kanë shkuar Policia Rrugore, Tiranë për zhblokimin e trafikut dhe 3 automjete zjarrfikëse me 3 motopompa për largimin e ujit.

Marikaj, te liqeni Marikaj, ditën e djeshme niveli i ujit arriti kuotën maksimale dhe digja doli jashtë funksionit. Për këtë u dërguan 3 mjete të transportit të rëndë, 1 ekskavator, 2 grupe me 20 ushtarë dhe 3000 deri në 5000 thasë plastike me rërë. Sakaq në fshatin Lakanas janë evakuuar disa banorëve pasi ka prezencë uji. Mësohet se në Tiranë ka pasur probleme me furnizimin me energji elektrike në Sauk, Paskuqan, Ibë, Zall-Bastar, Pezë, Shkallë, Mullet, Pezë Helmes, Shënmeri, Prezë, Tufinë, Gjokaj, Ndroq, Mërzëz, Valias, Paskuqan, Kombinat.



Forca të emergjencave civile, duke evakuuar banorët e fshatit Hasan në Fushë-Krujë

SITUATA

Meteorologia: I rezikuar nga reshjet Jugut i Shqipërisë dhe pjesa qendrore e vendit

TIRANË-Meteorologia Lajda Porja paraqiti mëngjesin e djeshëm një tablo të situatës në mbarë vendin. Porja theksoi se përgjatë gjithë ditës së djeshme reshjet do të vazhdonin, por në zonat veriore situata paraqitet në kushte të stabilizuara. Sipas saj problemi me reshjet do të vijojë në jug dhe qendrorë të vendit. "Në fakt, zonat veriore, pjesa më e madhe e qendrës paraqiten në kushte të stabilizuara. Vranësira dhe shira do të jenë të pakta. Në mbrëmje pritet të ndërpriten reshjet. Zona jugore dhe qendra mbeten me reshje të dendura deri në mbrëmje. Më pas do të ketë periudha me intensitet të lartë. Në ora 2:00 të mëngjesit janë marrë këto të dhëna. Reshje intensive kanë qenë pas orës 04:00. Reshjet pritet të vijojnë me intensitet mesatar dhe të dendur. Nuk do të ketë ndalim të reshjeve, por presim që ato në mesnatë të jenë të pakonsiderueshme. E shtuna do të ketë reshje të pakta dhe kthjellime në territor. Po ashtu dhe në mesnatën e të shtunës do të ketë pak reshje. Për qytetin e Tiranës, reshjet kanë qenë të intensitetit të lartë pas orës 21:00. Në një orë ka pasur rreth 30 mm prurjeve të reshjeve"-tha meteorologia Lajda Porja.

STRATI

Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"-Pyll", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumi 21, faqe 82, rregjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lekë.

"-Pyll", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumi 21, faqe 81, rregjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Ermira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lekë.

"-Truall", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² truall dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumi 4, faqe 247, rregjistruar në pronësi të Armand Shuaipi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2173 Rep, Nr. 1409/2 Kol, datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 3,133,065.6 Lekë.

"-Arë+Truall", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallimone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumi 6, faqe 135, rregjistruar në pronësi të Bujar Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën Tirana sh.a me Kontratë Hipoteke Nr. 657 Rep, Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipoteke Nr. 1512 Rep, Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.12.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

United Nations Development Programme



VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancy.

Post Title:	National Consultant on Ethnographic Research
Type of Contract:	Individual Contract
Project:	Promoting Inclusive Labour Market Solutions in the Western Balkans
Duty Station:	Tirana, Albania
Duration of Assignment:	15 working days during the period of December 2017 - January 2018
Deadline for Application:	December 8, 2017
Job Description:	http://al.undp.org

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.



**FUSHË-KRUJË/
SHEMBET URA
E DROSË**

Reshjet intensive kanë krijuar situatë dramatike në Fushë-Krujë. Dalja nga shtrati e lumit Derven ka përmbytur 1500 familje. Sakaq e pakalueshme është rruga Fushë Krujë-Milot, pasi asfalti është çarë dhe është shembur ura e Drosë, që lidhë 4 qytete: Fushë-Krujë, Mamurras, Laç dhe Milot. Shkak i shembjes është bërë niveli i lartë i ujit të lumit, i cili është i rrëmbyeshëm. Në fshatin Derven, uji arrin në 2 m.



**KRUJË/
SHPËTOHEN
NËNA E FEMIJA**

Dhjetëra njerëz janë evakuuar nga Forcat e Armatosura, të cilat kanë shkuar në ndihmë të popullatës së rrezikuar nga përmbytjet. Dje një nënë me vajzën 3 vjeçe u evakuuan me helikopter nga ushtria, pasi shtëpia ishte rrethuar nga uji në fshatin Mallkuç të Krujës. Ministria Olta Xhaçka ka publikuar fotot nga operacioni i shpëtimit. Nënna shfaqet me fëmijën në prehër, ndërsa si t' mban dot lotët për ato që la pas.



**KURBIN/
IZOLOHET FSHATI
GOTULL**

Shirat e rrëmbyeshëm kanë krijuar situatë dramatike në Kurbin. Sipas raportimeve nga terreni, mësohet se qindra hektarë tokë janë përmbytur në fshatin Gotull. Përmbytjet kanë shkaktuar ngordhjen e qindra bagëtive që nuk janë larguar nga zona. Po kështu bëhet e ditur se nga reshjet është shembur një urë që lidhte fshatin Gotull me qendrën e Kurbin, duke izoluar banorët, të cilët kërkojnë ndihmë.



**KUKËS/
3200 BANORË
PA DRITA**

Moti i keq ka zhytur në terr 3198 banorë në qarkun e Kukësit. Punonjësit e OSHEE-së kanë ndërhyrë për riparimin e avarive, duke përdorur 10 mjete transporte. Ndërkaq, bëhet me dije se janë shtuar mbi mesataren prurjet e lumenjve e të përrënjeve, por pa probleme me përmbytjet. Në liqenin e Fierzës janë 2000 m³/s. Mësohet se 269.93 m është niveli i liqenit të Fierzës, që është rritur me 93 cm.



**TEPELENË/
RREZIKOHET URA
200-VJEÇARE**

Prurjet masive të lumenjve e përrënjeve rrezikojnë të marrin me vete edhe urën e vjetër 200-vjeçare të Ali Pashë Tepelenës, që lidh këtë qytet me fshatin Bëçisht. Mësohet se uji ka përmbytur edhe lagjen "Gurëz" në Tepelenë, ku janë evakuuar deri më tani 8 familje. Sipas raportimeve, është bërë i pakalueshëm për disa orë aksi rrugor Uji i Ftohtë-Tepelenë. Ndërsa ka pasur dëme edhe në toka bujqësore, ullishte e pemëtar.



Shënohet viktima e parë në Milot. "Tërbohet" Vjosa, nis evakuimi i 2500 familjeve

SHKURT

Shkumbini dhe Osumi dalin nga shtrati, përmbytje në Elbasan e Berat

Që nga mesdita e së premtes, lumi Shkumbini ka dalë nga shtrati në disa zona dhe ka përmbytur dhjetëra ha tokë bujqësore dhe sera. Sipas burimeve zyrtare, rezultojnë se përmbytje ka në Njësitë Administrative Papërr, Pajovë, Polis etj. Rrjedha e këtij lumi ka dalë nga shtrati dhe ka shkaktuar përmbytje të konsiderueshme. Për shkak të mbizotërimit të motit të keq, banorët shprehen se kanë frikë nga përmbytja e banesave. Ndërsa, në Çarrick stacioni i pompave të ujit është rrethuar nga të gjitha anët nga vërshimi i rrjedhës së Shkumbinit. Situata e rënduar paraqitet edhe në disa fshatra të bashkive të Gramshit, Librazhdit, Përrrenjasit, Peqinit dhe Belshit, ku në shumë fshatra mungon energjia elektrike. Në Njësinë Administrative Labinot Mal është bllokuar rruga për në fshatin Lamollë dhe nuk mund të qarkullojnë mjete. Rruga e Griqanit kalohet me vështirësi, pasi është përmbytur nga vërshimi i ujërave. Në Njësinë Administrative Tregan është shkatërruar rrjeti i ujësjellësit të fshatit Tudan. Situata paraqitet kritike edhe në Gjirokastër e Berat. Mësohet se nga furia e shirave është përmbytur kati i parë i spitalit dhe varrezat e Gjirokastër, ndërsa të gjitha rrugët e qytetit ndodhen nën pushtetin e ujit. Vërshimi i lumit Osum ka shkaktuar situatë dramatike edhe në Berat, ku ka nisur evakuimi i banorëve.

Rebeshi i shirave ka krijuar situatë kaotike në 12 rrethet e vendit. Për shkak të motit të keq janë përmbytur dhjetëra hektarë tokë e banesa në Kurbin, Fushë-Krujë, Durrës, Vlorë dhe Berat. Ndërkohë, janë organizuar operacione shpëtimi nga Forcat e Armatosura duke evakuuar banorët, që rrezikojnë nga vërshimi i lumenjve. Situata paraqitet më problematike në qarkun e Durrësit, ku nga vërshimi i lumit Erzen dhe lumit Zezë janë zhytur nën ujë dhjetëra shtëpi. Dalja nga shtrati e lumit Vjosë ka shkaktuar panik në Vlorë, ku ka nisur evakuimi i 2500 banorëve. Situata është e rënduar edhe në Berat, Gjirokastër, Sarandë, Përmet, Tepelenë dhe Memaliaj. Moti i keq ka shënuar dhe viktimitë e parë. Bëhet fjalë për 42-vjeçarin Afrim Dani nga Burreli, i cili humbi jetën pasditën e djeshme. Ai ishte duke udhëtuar me ambulancë në Burrell të bashku me nënën e tij 84-vjeçare, të cilën po e shoqëronin për në spital, kur në Milot automjeti është përplasur me një makinë tjetër e për pasojë ka dalë nga rruga. Mësohet se nëna e viktimitë nuk ka pësuar dëmtime dhe ndodhet aktualisht në spitalin e Shkodrës, për ku dhe ish-in nisur. Paraprakisht dyshohet se akidenti ka ndodhur për shkak të lagështirës në rrugë.

QARKU DURRËS
Me dhjetëra familje në zonën e ish-Kënetës në Durrës janë zhytur në ujë gjatë ditës së djeshme si pasojë e reshjeve të shumta, bllokimit të kanaleve dhe mospastrimit të tyre ndër vite. Të rëndoritur nga situata e krijuar, banorët i kanë kërkuar me ngulm kreut të rajonit të ish-Kënetës të ndërhyjë për të zhblllokuar një kanal, i cili përmbyt të gjithë zonën. Ndërkaq, në Shijak situata është alarmante për shkak të vërshimit të lumit Erzen. 20 familje janë shpërngulur nga banesat, ndërsa

Vërshojnë lumenjtë, situatë kaotike në Fushë-Krujë, Shijak dhe Vlorë

Erzeni përmbyt 20 banesa, Zeza rrezikon 200 familje



Nga përmbytjet në Fushë-Krujë



Lumi i Vjosës

DELVINË/ IZOLOHEN 350 FAMILJE

Stuhia e shirave nuk ka kursyer as shkatërrimin e urës, që shërbente për të lidhur fshatin Vanë me Delvinën. Sipas raportimeve nga terreni, 350 familje janë izoluar, pasi nuk kanë asnjë mundësi tjetër komunikimi me rrugën nacionale. Deri tani rrethi i Sarandës ka qenë më pak i prekur nga moti i keq dhe nuk ka pasur përmbytje, por me sa duket reshjet intensive kanë sjellë edhe problemet e para për banorët.

150 të tjera rrezikojnë të përmbyten në orët në vijim. "Në 6 vjet jemi përmbytur 6 herë e nuk kanë marrë asnjë masë. Lumi Erzen në kohën e Enver Hoxhës vetëm një herë doli nga shtrati", tha një 80-vjeçar, i cili ka braktisur shtëpinë e mbuluar nga uji. "Shtrati i lumit nuk u pastrua, lumi hyn shtëpi me shtëpi këtu e gjithë këto vite", pohon ai, ndërsa është aq i pafuqishëm yo vetëm përballë natyrës, por edhe njerëzve. "Përmbytje çdo vit, ndërsa na mbyllin gojën me nga një

batanije e makarona, pastaj vjen dimri prapë e ndodh e njëjta gjë", u shpreh një tjetër banor. Të dëshpëruar janë banorët e lagjes "Erzen", që kanë braktisur shtëpitë. Ata u lajmëruan nga bashkia të lënë shtëpitë. Disa prej tyre i kanë lënë, ndërsa të tjerë janë ngjitur në katet e dyta të banesave. Përmbytjet u kanë shkaktuar dëme shumë të mëdha fermerëve në Durrës. Serat në zonën e ish-Kënetës dhe të Shkozëtit janë nën ujë. Edhe në lagjen nr.13 në plazh, për shkak të situ-

atës së krijuar është stakuar furnizimi me energji elektrike dhe për pasojë janë stakuar pompat, duke krijuar probleme për largimin e ujit. Nisur nga situata e krijuar, prefekti i Durrësit, Roland Nasto ka mbledhur dje shtabin e emergjencave. Nasto tha se gjendja pritet të përkëqësohet për shkak të reshjeve që do ta shtojnë intensitetin në orët në vazhdim, ndaj duhet të merrnin masa urgjente. Situata paraqitet dramatike në zonën e Fushë-Krujës. Dalja nga shtrati i lumit Zezë ka rrezikuar 200 familje të tri fshatave përreth, ndërsa 7 familje janë evakuuar nga banesat e tyre. Mësohet se stacioni i Ujësjellësit, në afërsi të Urës së Gjolës është përmbytur duke krijuar probleme për furnizimin me ujë të pijshëm në Shijak, Xhafzotaj, Gje-palaj, Maminas, Forcat e Armatosura të Ushtrisë kanë

evakuuar gjatë natës 23 persona në zonën e Llixhëve në Krujë. Në mesin e 23 personave të evakuuar është edhe një foshnjë 5-muajshe. Të paktën 50 forca të ushtrisë shkuar pranë banorëve të Fushë-Krujës, që ishin pushtar nga uji dhe prisnin të evakuoeshin.

QARKU VLORË

Edhe në qarkun e Vlorës vijon të paraqitet e rëndë situata, për shkak të reshjeve të dendura të shiut. Pas mbledhjes së Shtabit të Emergjencave, u ra dakord të evakuoeshin 2.500 banorë të 6 fshatave, banesat e të cilëve preken nga lumi Vjosë. Banorët do strehohen tek konviktet i shkollës industriale dhe tek pallati i sportit. Sipas autoriteteve, do ketë evakuim me forcë të qytetarëve nëse kundërshtojnë. Është duke u monitoruar situata në Kashihtë ku u investua argjinatura e re pas përmbytjeve të 2015-ës, investim që kapi shifrën 600 milionë lekë. Pritet që prurjet e Vjosës të kalojnë argjinaturën, ndërkohë që në Novoselë rriten prurjet e këtij lumi deri në 6.5 m. Lumi Vjosë ka dalë nga shtrati që prej mëngjesit të djeshëm. Si pasojë e përmbytjeve ka nisur edhe evakuimi i gjësë së gjallë në disa zona si: Novoselë, Fitore, Bishan etj. Situata prezantohet e rënduar edhe në Bashkinë e Selencës, ku sipas të dhënave janë rritur ndjeshëm edhe prurjet e lumit Shushicë, aktualisht rrezikohet zona e njohur si Bishti i Malit dhe Ura e Gjorimit.

PERMBYTJET KRYEMINISTRI

Kryeministri shkon në Mifol, përgëzon kryetarët e bashkive pa dallime partiake



ILIR META
Presidenti i Republikës shpreh dje solidaritetin me familjet e prekura nga përmbytjet. "Dua t'i ftoj të gjithë të bashkëpunojnë me forcat e ushtrisë, policisë dhe Emergjencave Civile që janë në terren, duke i falënderuar dhe inkurajuar që të vazhdojnë të jenë pranë qytetarëve për të kaluar këtë situatë dhe parandaluar përshkallëzimin e saj", u shpreh Meta.

Negotiatat me BE, Rama axhendë

takimesh në Bruksel

Qeveria shqiptare do të zhvillojë javën e ardhshme takime të nivelit të lartë në Bruksel, mbi temën e hapjes së negociatave me Bashkimin Europian. Axhenda e Komisionit Europian, zbardhur nga "SCAN", tregon se kryeministri Edi Rama, ministri i Europës dhe Punëve të Jashtme Ditmir Bushati, si dhe ministri i Punëve të Brendshme Fatmir Xhafaj do të priten nga zyrtarët më të lartë të Unionit. Takimet do të nisnin që ditën e hënë, kur ministri Bushati do të takojë zëvendës-presidentin e KE, Frans Timmermans. Ministri i Jashtëm do të pritet edhe nga Dimitris Avramopoulos, komisioneri për Çështjet e Brendshme dhe Migracionin. Këto dy takime të kryediplomatit shqiptar paraprijnë ato të nivelit të lartë, që do të zhvillohen nga kryeministri. Ditën e martë, Rama do të takojë presidentin e Komisionit Europian, Jean-Claude Juncker, si edhe Federica Mogherinin, përfaqësuese e lartë për punët e jashtme. Axhenda përmbyllet me takim me ministrin Xhafaj dhe komisionerin Avramopoulos ditën e mërkurë. Ndërkohë, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati u shpreh nga Uashingtoni, ku ishte për vizitë zyrtare se, "presim që 2018-a të jetë një vit përcaktues përsa i përket perspektivës europiane të Shqipërisë dhe natyrisht të kurorëzohet me një vendimmarje nga ana e vendeve anëtare të BE-së për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin me Shqipërinë".

Përmbytjet, Rama falënderon Bashën: Tregoi mirëkuptim

"Të shpëtojmë jetët e njerëzve, më pas shohim pasojat"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaxhcka dhe ministrin e Bujqësisë, Niko Peleshi inspektoi dje paradite zonën e Mifolit pranë Vlorës, një nga zonat me rrezikshmëri të shtuar për shkak të prurjeve të shtuara të lumit Vjosa. Ai u bëri thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë me strukturat e emergjencave civile në rastet kur është i nevojshëm evakuimi. Ndryshe nga më parë, kryeministri falënderoi dje mediën duke thënë se puna që gazetarët bëjnë në këto momente është e rëndësishme për informimin e njerëzve. Por, ai falënderoi edhe kreun e PD-së, Lulzim Basha. "Unë dua në radhë të parë të falënderoj Lulzim Bashën, kryetarin e Partisë Demokratike, i cili dje në mbrëmje (të enjten) shpreh mirëkuptimin për të ndërprerë diskutimet që ishin në rendin e ditës lidhur me buxhetin nga ana e opozitës e për të na dhënë mundësinë që ta mbyllim seancën në një kohë të arsyeshme, në mënyrë që të ishin në krye të detyrës", u shpreh kryeministri. E në vazhdim falënderimeve, ai vlerësoi punën e ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaxhcka, e cila ka qenë vazhdimisht në terren. "Besoj se kemi gatishmëri në maksimume se asnjëherë tjetër, sepse kemi nxjerrë mësimet e eksperiencave të shkuara, por edhe kalimi i Emergjencave Civile nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, si rezultat i reformës që ne kemi nisur, ka përfutueshmëri dhe vet", u shpreh kryeministri. Ai shtoi se, "situata ishte e paralajmëruar". "Natyrisht që fuqitë njerëzore, logjistike, ju tonat por të çdo shteti, sado të madh, në këto raste janë të kufizuara. E rëndësishme është që deri tani, falë operacioneve të shpëtimit, posaçërisht gjatë natës këtu ka qenë vërtetë shumë e vështirë, pastaj dita është më e lehtë, është siguruar që të mos kemi humbje në jetë njerëzish. Për fat të keq ka humbur jetën një punonjës i OSHEE-së në krye të detyrës dhe unë i shpreh të gjitha ngushëllimet familjes, me shpresën se do të mundem t'i vizitoj edhe drejtpërdrejt për t'i shprehur ngushëllimet sy në sy, me mirënjohjen dhe respektin më të thellë për njeriun që duke i shërbyer publikut si një punonjës i shtetit u nda fatkeqësisht e tragjikisht nga jeta", tha më tej Rama. Edhe prefektët, sipas tij kanë bërë një punë të shkëlqyer, duke u koordinuar me së miri. "Pa tjetër edhe të gjithë kryetarët e bashkive, pa dallim, për gjithë punën që kanë bërë dhe po bëjnë", falënderoi më tej, kreu i qeverisë. "Dua të përsëris apelin që të gjithë qytetarët



Kryeministri Edi Rama me ministrin e Mbrojtjes, Olta Xhaxhcka dje në Mifol

PETRIT VASILI

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së kërkoi dje shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. "Të shpallët gjendja e jashtëzakonshme. Çpret akoma qeveria?! Shqipëria po përballet me një situatë shumë të rëndë në të gjithë territorin, me rreziqe shumë të mëdha për pronën dhe shëndetin e qytetarëve", -tha Vasili.

Basha, Ramës: Ndhimmo banorët e prekur nga përmbytjet

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha viza ttoi dje familjet e prekura nga përmbytjet në Bashkinë e Kamzës. Z.Basha u takua me disa prej familjeve të përmbytura në Bashkinë e Kamzës, ku zonat për problematike janë Valias, Frutikultura, Laksina dhe një pjesë e Bathores. Nga takimet me banorët e prekur, kreu i opozitës konstatoi se dëmet janë të mëdha, por fatmirësisht, kryebashkiaku Xhelal Mziu ia ka dalë pa mbështetjen e pushtetit qendror të nxjerrë nga rreziku i përmbytjes më shumë se 250 familje. Teksa inspektoi Valiasin, ku zona e Frutikuturës është më e prekura nga shkakimi i liqenit të Bovillës dhe reshjet e dendura, Basha i kërkoi qeverisë të bëjë gjithçka për t'u ardhur në ndihmë banorëve. "Situata do të përqendrohet prapë sonte. Të nxjerrim njerëzit, të shpëtojmë njerëzit. Të mos rrinë pas lopëve, por të shpëtojmë njerëzit, pastaj hap pas hapi të tjerat. Vëmendja kryesore duhet të jetë të jeta e njerëzve", deklaroi z.Basha. Ai këshilloi banorët që të bashkëpunojnë me Emergjencat Civile për të shmangur çdo humbje njerëzore. Nga ana tjetër, banorët iu ankuar kreu të opozitës për braktisje nga autoritetet qeveritare dhe se deri tani ia kanë dale vetë, ose me ndihmën e bashkisë.

në zonat e paralajmëruara si zona të prekshme në vijim, pasi parashihet një fryrje e mëtejshme dhe sipas të gjitha gjasave, masive e lumit të Vjosës nga prurjet që vijjnë prej matanë kufirit dhe që sjellin pastaj prekjen e shumë zonave në këtë pellg, në mënyrë që të jenë vazhdim të vëmendshëm e t'i përgjigjen siç duhet kërkesës

së strukturave për t'u evakuuar, për t'u spostuar", tha Rama. "Të shpëtojmë jetët e njerëzve, të mos kemi humbje në jetë. Të shpëtojmë sa të mundemi bagëtitë e pastaj kur del dielli, vjen pjesa tjetër e bilancëve dhe e përpjekjeve për rikuperim. Kjo besoj është pamja për momentin e kësaj situatë", theksoi Rama nga Mifoli.

Berisha: Rama të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme

Ish-kryeministri Sali Berisha dha dje alarmin se situata e përmbytjeve mund të bëhet me katastrofike dhe kërkoi të shpallët menjëherë gjendja e jashtëzakonshme. Madje, Berisha i bërë thirrje edhe Presidentit Ilir Meta, "që në një situatë të tillë pa përgjegjshmëri të kreu të ekzekutivit të konsiderojë edhe thirrjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare". "Të dhënat sinoptike për orët që vijjnë nuk janë premtuese. Në këto kushte është e domosdoshme shpallja menjëherë e gjendjes së jashtëzakonshme në shkallë vendi dhe mobilizimi i të gjitha potencialëve në ndihmë të zonave dhe komuniteteve më të rrezik. Gjendja e jashtëzakonshme ka ligjin, i cili përcakton qartë detyrimet e shtetit në situata të tilla ndaj zonave të prekura nga katastrofat natyrore. Edi Rama nuk e merr këtë vendim vetëm e vetëm për të shmangur detyrimet e shtetit ndaj qytetarëve. Mosshpallja e gjendjes së emergjencës është një akt i papërgjegjshëm, antikushitetues i Noriegës! Ftoj Presidentin e Republikës që në një situatë të tillë papërgjegjshmëri të kreu të ekzekutivit të konsiderojë edhe thirrjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare", shprehet z.Berisha.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 06.12.2017 ne oren 16:00 ne zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Irlisa Tereziu PF Me adresë ne : Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, njesia Tregtare nr. 10 Tirane, zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Njesi" me siperfaqe totale 87.2 m2, numer pasurie, 15/231 -N1, vol.2014 -2016, ne zonen kadastrale 8551 me adrese Kavaje. Cnimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 5,830.687.52 (pese milionin e teteqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e tetedhjetë e shtate oikë pesedhjetë e dy Lek.)



NJOFTIM I ALBTELECOM Sh.A.

ALBtelecom njofton të gjithë pajtimtarët e tij të telefonisë fikse se paketat për pajtimtarët Individual +Fiks (1.499.1.999, Super 30) dhe ALBtv (Small, Small Filestore, Medium, Medium Familjare, Large, Large Familjare, Extra Large, Extra Large Premium, Super 100, Super 100 Premium), si edhe paketat për pajtimtarët Biznes +Fiks (Large, Extra Large), Biznes ALBtv (Large, Extra Large), pas datës 11 dhjetor 2017 nuk do të jenë më të vlefshme për aktivizime të reja. Të gjithë ata pajtimtarë, të cilët deri në këtë datë, kanë lidhur ose lidhin kontratë për këto paketa, nuk do të preken nga ky ndryshim, sipas kushteve dhe afatëve të përcaktuara në kontratat përkatëse. Tashmë, për të gjithë pajtimtarët individual dhe Biznes, të cilët duan të lidhin një kontratë të re ose të rinovojnë kontratën ekzistuese në shërbimet fikse, ALBtelecom ofron paketat SUPERFIKS, për të kombinuar të 3 shërbimet: IPTV, Internet dhe Telefoni Fiks, me çmimin dhe vëllimin shumë të favorshme.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.

Debati, "Zgjedhorja" përplas PD me të vetët, Shehi: Të ndryshojë sistemi

Financat e partive, PD: Jo burime të errëta. PS: Ta nisim me lobimet

Miratojen 8 ekspertë për amendimin e ligjit

Valentina Madani

Komisioni parlamentar për Reformën Zgjedhore u përfshi dje nga debatet, teksa diskutoi për hapat e mbetur që do të çojnë në ndryshimin e radhës së sistemit elektoral. Komisioni miratoi 8 ekspertë që do të punojnë me amendimin e ligjeve, të cilët do jenë nga 4 për secilin krah politik. Mbledhja filloi me koordinimin e dy bashkëkryetarëve, Oerd Bylykbashi dhe Bledi Çuçi, të cilët kërkuan që anëtarët e komisionit të shprehnin çështjet kryesore që ata mendonin se komisioni duhet të diskutonte. Vetë Bylykbashi ngrii çështjet e heqjes së personave me precedentë penalë nga parlamenti duke rreguluar



Komisioni parlamentar për Reformën Zgjedhore

uar legjislacionin, ashpërsimin e legjislacionit për shitblerjen e votës dhe krimin zgjedhor, identifikimin, votimin dhe numërimin elektronik, përdorimin e administratës në zgjedhje dhe financimin e partive politike. Bashkëkryetari socialist, Bledi Çuçi u shtoi këtyre çështjeve edhe depolitizimin e komisioneve zgjedhore. I vetmi që

foli për nevojën e ndryshimit të sistemit elektoral ishte deputeti Dashamir Shehi. Ndaj përpara arrijtes së një konsensusi me mazhorancën e majtë, demokratëve u duhet të gjejë gjuhën e përbashkët me aleatët e tyre lidhur me reformën zgjedhore. Që në mbledhjen e parë pas konstituimit të komisionit, që u mbajt vetëm pak minuta i

hapur për mediat, u shfaqën edhe përplasjet e para. Për bashkëkryetarin e Komisionit të Reformës Zgjedhore, demokratit Oerd Bylykbashi, përdorimi i teknologjisë si dhe dekriminalizimi i zgjedhjeve duhet të jenë kryefjalë e këtij procesi. Identifikimi biomëtrik, votimi dhe numërimi elektronik janë një domosdoshmëri që duhet të marrin zgjidhje nga ky komision. Futja e teknologjisë në zgjedhje do të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në proceset elektorale. "Ka pasur presion jo vetëm nga administrata publike për votën, por edhe nga privatët. Duhet një institucion i pavarur për këto çështje me rëndësi, si dhe për transparencën financiare të partive. Burimet duhet të jenë sa më të qarta. Financuesi kryesor duhet të jetë shteti, nuk ka pse të ketë nevojë për financime të errëta", deklaroi z.Bylykbashi. Por deputetja e PS-së, Ermonela Felaj iu përgjigj: "Shumë mirë që PD-ja është e shqetësuar për financimin e partive. Kurse aleati i demokratëve, kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi vendos një tjetër prioritet të krye të punës së komisionit. "Numërimi elektronik është një çështje teknike, gjithçka duhet të nisë nga sistemi, që është kryefjalja e reformës. Do të rrimë të ky sistem që

DEBATET NË KOMISIONIN E REFORMËS ZGJEDHORE

OERD BYLYKBASHI: Ka pasur presion jo vetëm nga administrata publike për votën, por edhe nga privatët. Duhet një institucion i pavarur për këto çështje me rëndësi, si dhe për transparencën financiare të partive. Burimet duhet të jenë sa më të qarta. Financuesi kryesor duhet të jetë shteti, nuk ka pse të ketë nevojë për financime të errëta. Duhet parë me seriozitet çështjet e heqjes së personave me precedentë penalë nga parlamenti duke rregulluar legjislacionin, ashpërsimin e legjislacionit për shitblerjen e votës dhe krimin zgjedhor, identifikimin, votimin dhe numërimin elektronik, përdorimin e administratës në zgjedhje dhe financimin e partive politike.

BASHKIM FINO: Ky debat është i panevojshëm dhe i tejkaluar. Kemi debatuar më 13 tetor në parlament, kur ngritëm komisionin. Është e tepër të ridëgjohet të njëjtat gjëra. Duhet të ngremë sa më shpejt grupin e ekspertëve dhe t'u japim detyra për çështjet që tashmë dihen. Koha është e florinjte në rastin konkret.

BLEDI ÇUÇI: Ne duhet të merremi seriozisht me depolitizimin e komisioneve zgjedhore.

Ermonela Felaj: Shumë mirë që Partia Demokratike është e shqetësuar për financimin e partive. Të marrim ekspertizë të veçantë për lobimin e partive.

DASHAMIR SHEHI: Numërimi elektronik është një çështje teknike, gjithçka duhet të nisë nga sistemi, që është kryefjalja e reformës. Debatet këtu është sistemi. Do ta ndryshojmë apo jo? Këtë duhet të diskutojmë ne. Do ta korrektojmë? Duhet ta fillojmë nga sistemi. Ky ndryshim sjell më pas automatikisht edhe depolitizimin e komisioneve. Do të bëjmë ndonjë punë sot, edhe për lezet? Sistemi është kryefjalja. Pjesa teknike vjen nga fatkeqësia jonë se po vjedhim votat e një-tjetrit.

OERD BYLYKBASHI: Duhet gjetur një mundësi votimi efektive dhe Partia Demokratike është e hapur për të diskutuar. Duhet rishikuar ligji për referendumet, për të forcuar këtë mekanizëm të drejtpërdrejtë qytetar.

laroi z.Bylykbashi. Por deputetja e PS-së, Ermonela Felaj iu përgjigj: "Shumë mirë që PD-ja është e shqetësuar për financimin e partive. Kurse aleati i demokratëve, kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi vendos një tjetër prioritet të krye të punës së komisionit. "Numërimi elektronik është një çështje teknike, gjithçka duhet të nisë nga sistemi, që është kryefjalja e reformës. Do të rrimë të ky sistem që kemi, apo do ta ndryshojmë atë? Ky ndryshim sjell më pas automatikisht edhe depolitizimin e komisioneve", tha z.Shehi. Aleatët e PD më herët i kanë kërkuar Lulzim Bashën ndryshimin e sistemit aktual zgjedhor. Kreu i LZHK-së mbështet idenë e një sistemi maxhoritar, ndërsa demo-kristiani Nard Ndoka, atë kombëtar preferencial. Partitë e kampit opozitar janë shprehur gjithashtu pro listave të hapura.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII I POSAÇEM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjykatëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelit".

I - Shpall vendet vakante për pozicionet:

1. Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Mardhënies me Median dhe Publikun
Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

2. Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

3. Specialist Sekretarie Gjyqësore

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

4. Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

5. Përkthyes

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip.
 - Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
 - Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

6. Koordinator për mediat dhe mardhëniet me jashtë

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit të Lartë në Drejtësi/ Gazetari/Gjuhë-Letërsi etj.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e mardhënies me median/ mardhëniet me jashtë.

7. Specialist për prritjen me popullin

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

II - Rishpall vendet vakante për pozicionet:

8. Specialist Financë/Buxhet

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
 - Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

9. Specialist i Burimeve Njerëzore

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

10. Specialist IT

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inzhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
 - Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
 - Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
 - Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
 - Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve ëeb (Eordpress, Drupal, Joomla etj).
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

11. Specialist Protokolli/Arkive

- Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongresveve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongresveve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 15 Dhjetor 2017, i cili duhet të vërtetohet me letë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmim nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) origjinal ose të notorizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimeve pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

BB: Spitalet e ilaçet varfëruan 126 mijë shqiptarë

Faturat e spitaleve, shqiptarët paguan 325 milionë euro nga xhepi

Fatura, që paguajnë shqiptarët në një vit për shërbimet që marrin në spitale dhe ilaçet, arrin në 325 milionë euro. Shqiptarët shpenzojnë nga buxheti i tyre për shëndetësinë më shumë se çdo vend tjetër në rajon. Qeveria merr përsipër të paguajë vetëm gjysmën e shpenzimeve të kurimit duke i lënë gjysmën e barrës vetë qytetarëve. Të dhënat janë bërë publike në një raport të Bankës Botërore ku mësohet se shpenzimet për kurim në spitale dhe blerja e ilaçeve kanë varfëruar 126 mijë shqiptarë ose 4.5 për qind të popullsisë. Kjo është shifra më e lartë në Europë. Sipas Bankës Botërore, shkaku se pse shëndetësia varfëron kaq shumë njerëz në Shqipëri është se qeveria mbulon vetëm gjysmën e kostos së sëmundjeve, duke ia ngarkuar gjysmën tjetër vetë familjeve.



Foto ilustruese

SHPENZIMET

Banka Botërore deklaroi se pagesat për spitale dhe shpenzimet për blerjen e ilaçeve kanë zhytur në varfëri 126 mijë shqiptarë ose 4.5 për qind të gjithë popullsisë. Shifrat tronditëse janë bërë publike në një raport mbi gjendjen e ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Sipas Bankës Botërore, shpenzimet shëndetësore në Shqipëri varfërojnë më shumë njerëz se në çdo vend tjetër të Europës, përfshirë dhe

ekonomitë e ngjashme në Ballkan. Në Kosovë, pjesa e popullsisë që ka rënë në varfëri nga shpenzimet mjekësore është 2.4 për qind, ndërsa në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe Bosnjë shifra është nën 1.5 për qind. Arsyeja sipas bankës botërore pse shqiptarët shpenzojnë aq shumë për mjekim është se qeveria ia ka ngarkuar qytetarëve gjysmën e barrës së shpenzimeve për kurim dhe ilaçe. Shqipëria shpenzon rreth 650 milionë euro në vit për sistemin shëndetësor. Në fushatën elektorale të vitit 2013, Partia Socialiste premtoi shëndetësi falas, duke u zotuar se e gjitha kjo kosto

do të mbulohej nga buxheti i shtetit përmes taksimit të përgjithshëm. Por, sipas Bankës Botërore, në vitin 2014, që janë dhe të dhënat më të fundit të disponueshme, qeveria mbuloi vetëm gjysmën e faturës, ndërsa gjysmën tjetër ose rreth 325 milionë euro, qytetarët u detyruan ta paguanin nga xhepi. Kjo është shifra më e lartë në rajon. Në Malin e Zi, qytetarët paguan vetëm 42.8 për qind të faturës së shëndetësisë nga xhepi i tyre, ndërsa në vendet e tjera të rajonit shifra është edhe më e ulët duke variuar nga 28 në 37 për qind, pasi pjesën tjetër e mbulon qeveria.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje programesh Software, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 11,400,500 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje programesh Software, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Oftëra duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 26 Dhjetor 2017, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



UNHCR
United Nations High Commissioner for Refugees
Haut Commissariat des Nations Unies pour les réfugiés

INTERNAL AND EXTERNAL VACANCY NOTICE

ALB/TIR/17/GS/03

Office of the United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) in Tirana, Albania is looking for qualified and highly motivated candidates interested to apply for the following position:

Title of Position:	Protection Associate, G6
Position Number:	10008684
Note:	The position has a lien until 03rd June 2018. The selected candidate will be deemed in replacement capacity until the lien is relinquished or until the regular incumbent returns to the post.
Duty Station:	Tirana, Albania
Type of contract:	Standard Position GS6 (General Service)
Tentative starting date:	1 January 2018
Duration:	Initially 1 year
Application Deadline:	16 December 2017, 17:30 CET

1. ORGANIZATIONAL CONTEXT Define the role of the position within the team, describing its leadership role, if any, its external/internal work relationships or contacts, the contextual environment in which it operates and the scope of supervision received, and where applicable, exercised by the incumbent.

The Protection Associate normally reports to the Protection Officer or the Senior Protection Officer. He/she monitors protection standards, operational procedures and practices in protection delivery in line with international standards and provides functional protection support to information management and programme staff.

The Protection Associate is expected to coordinate quality, timely and effective protection responses to the needs of populations of concern and identify opportunities to mainstream protection methodologies and integrate protection safeguards in operational responses in all sectors. He/she contributes to designing a comprehensive protection strategy and liaises externally with authorities and partners on protection doctrine and policy as guided by the supervisor.

The Protection Associate also ensures that persons of concern are involved with the Office in making decisions that affect them, whether in accessing their rights or in identifying appropriate solutions to their problems. To achieve this, the incumbent will need to build and maintain effective interfaces with communities of concern, local authorities and protection and assistance partners.

The Protection Associate will have the overall supervision of border monitoring activities with the aim to enhance access to the asylum procedures and access to the Albanian territory. He/she will strengthen strategic partners at the national and local level in order to enhance UNHCR monitoring capacity, and facilitate coordination of governmental and non-governmental institutions. He/she will actively engage with civil society organizations, INGOs and the Ombudsman's office and explore synergies regarding protection monitoring and advocacy interventions. He/she provides technical support to Border and Migration Police (BMP) to ensure that persons in need of international protection willing to present their requests/applications in Albania, are adequately informed of their rights and responsibilities. Moreover, the protection associate will assist the Protection unit with capacity building initiatives to national authorities, relevant institutions and NGOs to strengthen protection related policies and procedures.

2. FUNCTIONAL STATEMENT

Accountability (key results that will be achieved)

- The protection of populations of concern is met through the application of International and National Law, relevant UN/UNHCR protection standards and IASC principles.
- Protection activities are guided by the UNHCR country protection strategy.
- The participation of persons of concern is facilitated through continuous assessment and evaluation using participatory, rights based and community based approaches.
- Protection incidents are immediately identified and reported.

Responsibility (process and functions undertaken to achieve results)

- Stay abreast of political, social, economic and cultural developments that have an impact on the protection environment.
- Consistently apply International and National Law and applicable UN/UNHCR and IASC policy, standards and codes of conduct.
- Assist in providing comments on existing and draft legislation related to persons of concern.
- Provide advice on protection issues to persons of concern; liaise with competent authorities to ensure the issuance of personal and other relevant documentation.
- Assist in conducting eligibility and status determination for persons of concern.
- Contribute to measures to identify, prevent and reduce statelessness.
- Contribute to a country-level child protection plan as part of the protection strategy.
- Contribute to a country-level education plan as part of the protection strategy.
- Monitor Standard Operating Procedures (SOPs) for all protection/solutions activities.
- Manage individual protection cases including those on SGBV and child protection. Monitor, and intervene in cases of refoulement, expulsion and other protection incidents.
- Assist in identifying durable solutions for the largest possible number of persons of concern through voluntary repatriation, local integration and where appropriate, resettlement.
- Contribute to the design, implementation and evaluation of protection related AGD based programming with implementing and operational partners.
- Contribute to effective information management through the provision of disaggregated data on populations of concern and their problems.
- Participate in initiatives to capacitate authorities, relevant institutions and NGOs to strengthen national protection related legislation and procedures.

Authority (decisions made in executing responsibilities and to achieve results)

- Prioritize persons of concern for interview, counselling and propose protection support for individual cases.
- Enforce compliance of local implementing partners with global protection policies and standards of professional integrity in the delivery of protection services.
- Enforce compliance with, and integrity of, all protection standard operating procedures.
- Submit individual payments request for persons of concern for approval.

3. MINIMUM REQUIRED COMPETENCIES

- Judgement and Decision Making
- Analytical Thinking
- Political Awareness
- Stakeholder Management

4. ESSENTIAL MINIMUM QUALIFICATIONS AND PROFESSIONAL EXPERIENCE REQUIRED

- Education: Completion of secondary school. Additional certificate/training in International Law, Political Science or related field is required.
- Job experience: Relevant to the function: 6 years.
- Fluency in English and working knowledge of another relevant UN language or local language.

(In offices where the working language is not English, excellent knowledge of UN working language of duty station and working knowledge of English).

5. DESIRABLE QUALIFICATIONS & COMPETENCIES

- Good computer skills.
- Completed Protection Learning Programme.

IMPORTANT NOTE:

- Interested candidates should read the Terms of Reference carefully and apply if suitably qualified.
- Candidates are required to submit signed Motivation Letter and UNHCR P11 form.
- UNHCR P11 form and Supplement form are available: UNHCR Personal History Forms (open Hyperlink)
- Please note that any previous versions of the P11 will no longer be considered.
- Applications of father, mother, son, daughter, or siblings of a staff member of UNHCR cannot be considered.
- Applications will not be acknowledged. Only shortlisted candidates will be contacted and invited for the written test and the interview.
- Applicants with working experience in International Organizations, preferably United Nations, are highly encouraged to apply.
- For any query please contact: albt@unhcr.org

Interested candidates should submit their applications (Completed UNHCR Personal History (P11) form, P11 Supplement form and Motivation Letter) electronically by e-mail to: albt@unhcr.org or in the sealed envelope addressed to: UNHCR Albania, Skenderbej Str., Gurien Building, 2nd floor, Tirana, Albania referring to the Vacancy Notice reference UNHCR: ALB/TIR/17/GS/03.

Deadline for submitting applications is **16 December 2017, 17:30 CET**. Late or incomplete applications received without the above specified documents will not be considered;

Dje **ne** 'Deutsche Welle'

Jurgen Hanefeld

(Vijon nga faqja e parë)

... thuhej asokohe, "i parashikueshmi", "njeriu me ngërdheshjen e trashë në fytyrë". "E kush e di edhe sa kohë do t'i duhet atij të merret me këtë?". Por, kur dy vjet më vonë Kim deklaroi se do të vazhdojë më tej në rrugën drejt një fuqie atomike e pastaj do të negociojë me SHBA-të për çarmatimin, atë e përqeshën. Ndërsa tani duket se edhe më i humburi e ka kuptuar që ky njeri e ka seriozisht.

NJË DITË HISTORIKE?

Natyrisht askush nuk e di se sa precize janë raketat e tij dhe nëse ai tani do të ishte vërtetë në gjendje të ushësonte Nju Jorkun apo Uashingtonin. Por a duam ne vërtet ta dimë këtë? Kush nuk do të preferonte më mirë ta peshonte me arsye këtë rrezik se sa të hynte në këtë valle? Nëse e mërkura do të hyjë në histori si një ditë historike, këtë ende nuk e dimë. Por ajo i përbush kriteret për të qenë e tillë: Koreja e Veriut e ka shpallur veten fuqi atomike! E madje, me gjithçka përfshin ky status. Kjo nuk nënkupton vetëm një përfundim të



kërcënimit, por nënkupton njëkohësisht edhe një ofertë. Sepse kushdo e di, që edhe sikur raketat e Penjanit të mund të arrijnë çdo vend në SHBA - ato mund ta bëjnë këtë vetëm një herë. E paskëta nuk ekziston më as Penjani e as një Kore e Veriut, apo një e Jugut.

Çfarë ka Kim vërtetë në mendje? Ai do të mbrojë veten. Ai do të qëndrojë në pushtet. Ndaj do të negociojë në nivel si i barabartë me SHBA-të. Jo me Korenë e Jugut, për të cilën ai e di, se ky vend të paktën në aspek-

tin ushtarak ecën në linjën e SHBA-ve. Ai nuk do të negociojë as me Kinën, e cila luhet mes interesave të saj ekonomike dhe atyre strategjike. Kim kundër Trump - kjo është loja ku i var shpresat Koreja e Veriut! **BËHET FJALË PËR PAQEN**

"Çfarë foddullëkul!" mund të shfrysh tani, "çfarë arrogance!" - por po të gjykosim me mendje të ftohtë, nuk ka alternativë tjetër. Pavarësisht gjithë aeroplanmbajtëseve, superfuqisë së tij kolosale ushtarake, Trump

nuk mund të bëjë asnjë lëvizje pa e rrezikuar Korenë e Jugut e madje me gjasë edhe pa provokuar një luftë botërore. Krahasuar me rrethana të tilla, a nuk do të ishte më mirë një sakrificë e vogël për egon e presidentit të SHBA-ve, që të flasë me Kim në vend që të shkruajë në "Twitter" për të? Ky nuk do të ishte i pari diktator me të cilin Amerika do të duhej të bashkëvepronte. Shpesh në ujdë të tilla me dhespotë bëhet fjalë për naftë, armë e para. Ndërsa kësaj here është fjala për paqen.

Koreja e Veriut do të jetë fuqi atomike

SHKURT

Si u mor peng kreu i kartelit të drogës, Spiros Kardamis

GREQI - Spiros Kardamis, i cili rezultoi të jetë pronar i 3 prej 4 gomoneve, i akuzuar si organizator i trafikut të drogës nga Shqipëria, sipas mediave greke rezultoi të jetë marrë peng para 6 vitesh. Media greke "To Vima" shkruan se 63-vjeçari më parë ka qenë pronar i një restoranti italian në Korfuz, ndërkohë që prezantohej si pronar i një kompanie pajisjesh elektronike. Ai pretendon se i është bërë presion nga trafikantët shqiptarë. Para 6 vitesh, ai rezultoi të jetë marrë peng bashkë me një miken e tij ukrainase në Notia Proastia, Athinë. Pengmarrësit rusë e çuan atëherë në një zonë të shkretët dhe i kërkuan 500.000 euro. Pavarësisht se është pronar restorantesh, rezultoi se babai i dy fëmijëve (familja e të cilit të cilët është me banim në Itali) merret akoma me tregti elektro-shtëpiakësh. Po ashtu "To Vima" shkruan se ai ka marrë dy avokatë të njohur në Greqi, të cilët janë Fransisko Raguzi dhe Katerina Stavrou. Ata pretendojnë se klienti i tyre i kishte skafet për t'i dhënë me qira tek turistët. Gjithashtu, po hetohet lidhja e këtij grupi me raste të tjera të trafikimit të drogës si dhe lidhja e tyre e mundshme me policë të rojës bregdetare.

1.6 tonë drogë me gomone nga Shqipëria, jepet vendimi për 11 të arrestuarit

GREQI - Prokurori i Pireut ka përfunduar dhënien e masave të sigurisë për të arrestuarit e çështjes së 1.6 drogës me gomone. Sapo përfunduan masat e fundit për dy grekë, dy shqiptarë dhe një bullgar, ndërkohë që dje dhe pardje u dhanë masat për 4 shqiptarë e dy italianë. Prokurori ka kërkuar të lërë në burg të gjithë të akuzuarit. Dje u mor masa për 63-vjeçarën Spiros Kardamis, 43-vjeçarën Dimitrios Liakopoulos, 32-vjeçarën Arban Baxheri, shqiptarin tjetër Ermal Likaj dhe bullgarin Yordan Stoyanov. Nga ana e tij, Spiro Kardamis është shprehur se, "kam kompani që blen skafet, por nuk kam lidhje fare me trafikun e drogës". Një nga drejtuesit e grupit, Vito Potenza, 31 vjeç deklaroi dje në seancë: "Ndodhesha në Greqi, sepse do merrja një nga gomonet e Spiros që ta çoja në Itali për riparim. Nuk kam lidhje fare me trafikun". Skafisti 57-vjeçar, Sergio Racanato që iu bë seanca të martën, deklaroi: "Kisha shumë para borxh, m'u bë presion nga grupi dhe u detyrova të bëja rrugën".

Bëjini të gjithë të lumtur

Kredi Personale

Këto festa dhuroni pa fund me kredinë personale



Raiffeisen BANK

www.raiffeisen.al



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 587

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 2 Dhjetor 2017

SA E FSHEHTE
PASKA QENE!
BANORJA E FAMSHME
E 'BIG BROTHER',
JO ME SINGLE



NDAHEN TUNA & PATRIS

Sherri që çoi në
largimin e këngëtares
nga shtëpia në Prishtinë



"NUK DO TA
SAKRIFIKOJA
NDERIN TIM
PER ASNJE
ÇMIM
KARRIERE"

ADA DEDA



NE SHTRAT ME SENSUALEN
ORIOLA
MARASHI



Provokon Françeska, vetëm me peshqir: A mund t'jua rregullojë humorin kjo foto?

Ajo njihet si një nga modelet e 'Instagramit' që provokon shpesh me fotot e saj 'hot' duke i kënaqur fansat e saj dhe duke u rregulluar humorin, pse jo. Edhe kësaj radhe ajo ka bërë përshtypje me një foto tepër provokuese ku shfaqet e veshur vetëm me peshqir, ndërkohë që e ka lënë të hapur duke ekspozuar gjoksin dhe jo vetëm. "A do të mund kjo foto të rregullojë humorin tuaj sot?,"- shkruan Françeska krahas fotos.




Në shtrat me sensualen Oriola Marashi

Bukurshja brune, Oriola Marashi nuk ka të ndalur në publikimin e fotove seksi dhe joshëse në rrjetin e saj social. Gjithnjë vjen në një mënyrë ndryshe, por gjithnjë provokuese me format e saj superseksi. Kësaj radhe shfaqet e veshur me një palë të brendshme të zeza, modelja seksi gjendet e shtrirë në shtrat në disa pozicione të ndryshme. Nuk ka se si mos të shkojnë sytë tek trupi i saj i gjatë e perfekt mbi të gjitha! Fotot e postuara njëra pas tjetrës nuk i lënë vend imagjinatës për të parë se si mund të duket një femër e tillë tepër joshëse në krevat. Nuk është hera e parë, që Oriola pozon kaq sensualisht, duke i lënë ndjekësit e saj pa fjalë.



Sa e fshehtë paska qenë! Banorja e famshme e 'Big Brother', jo më single

Ajo ka qenë padyshim një nga banoret më të lakuara të 'Big Brother Albania 1', por, Agjithashtu, edhe në edicione të tjera të këtij formati. Por prej disa muajsh Najada Konomi, ose, siç e njohim ndryshe "Noçja" ka nisur jetën e saj të re në Itali. Mesa duket edhe nga postimet në faqen e saj në 'Instagram', ish-banorja e 'BB1' i ka dhënë fund edhe beqarisë. Në profilin e saj ajo ka shkruar se është e "martuar" dhe, gjithashtu, këtë informacion e ka shoqëruar me emojin e një unaze. Por me aq sa pamë ne nuk na rezultojnë asnjë foto nga dasma e çiftit. Shumë misterioze dhe e kursyer paska qenë!



Një vit pasi zyrtarizuan lidhjen, dyshja i jep fund

NDAHEN

Tuna dhe Patris Berisha


Sherri që çoi në largimin e këngëtares nga shtëpia në Prishtinë

Pamela Aliaj

Gati një vit pasi u bë publike historia e dashurisë me Patris Berishën, çifti duket se i ka dhënë fund. Bëhet me dije se Tuna dhe partneri saj prej disa ditësh nuk janë më bashkë. Fillimisht dyshimet u shtuan pasi çifti nuk ndiqte më në rrjetet sociale njëri-tjetrin. Mediat kosovare nisën aludimet rreth një ftohje mes dyshes së famshme, por duket se kiza mes të dyve ka qenë më e madhe. "Bluetooth" ka mundur të mësojë se tashmë Tuna ka lënë shtëpinë ku jetonte bashkë me Patrisin në Prishtinë për t'u shpërngulur në Shkup, qytetin ku dhe jetonte para se të niste lidhjen me instrumentistin simpatik. Me aq



sa kemi mundur të mësojmë mes çiftit ka pasur një debat, që duket se ka përfunduar me largimin e këngëtares së mirënjohur nga shtëpia. Natyrisht që së bashku me Tunën është larguar nga shtëpia edhe vogëlushi Tian, që tashmë gjendet me nënën e tij në Shkup. Këngëtarja e ka fshirë dhe nuk e ndjek më Patrisin në profilin e saj teksa të njëjtën e ka bërë edhe në llogarinë e Tianit, të cilën e mban vetë. As aty, Patrisi nuk është 'following' dhe fotot e djalit tashmë janë ose vetëm ose me Tunën. Në një prej tyre të postuar së fundmi, Tuna ka prerë Patrisin duke e lënë në fokus vetëm Tianin. Ndërkohë, vetë Berisha nuk ka reflektuar sjellje të tillë të çuditshme. Ai vazhdon ta mbajë akoma Tunën në listën e



miqve që ndjek, duke lënë të kuptohet se në fakt, e pakënaqura në këtë meselë është këngëtarja. Çifti u pa së bashku rreth dy javë më parë. Të dashuruar dhe të kapur përdore Tuna dhe Patrisi

dukej sikur po jetonin ditët më të lumtura pranë njëri tjetrit, po gjërat mes tyre janë përmbytur shumë shpejt, duke sjellë edhe ndarjen e një prej çifteve më simpatikë në showbizin tonë.

Rrëfëhet vajza e ish-deputetes së PD: Mami, kritikja ime më

ADA DEDA:

Nuk do ta sakrifikoja nderin tim për asnjë çmim karriere

“S’kam marrë propozime për foto nudo, por do të sfiloja për ‘Victoria Secret’”

Pamela Aliaj

Ajo është një nga modelët bukuroshe, e cila ka pak kohë që ka nisur eksperiencën e saj në fushën e modelingut. Por një detaj tjetër i rëndësishëm është edhe fakti se bukuroshja Ada Deda është vajza e ish-deputetes së PD-Së, Albina Deda dhe kjo ka bërë që të jetë pothuajse gjithnjë në qendër të vëmendjes së mediave rozë. Në një intervistë ekskluzive për ‘Blue-tooth’ të ‘Gazeta Shqiptare’

Ada ka folur për herë të parë për ndjesitë në fushën e modelingut, marrëdhëniet me një nënë deputete dhe sidomos ‘konfliktet’ që ajo ka pasur me shtrembërimet e lajmeve në mediat rozë. Gjithashtu, Ada na ka rrëfyer edhe projektet e rëndësishme që e presin tani së afërmi në fushën e modelingut dhe ëndrrat e saj për të ardhmen. Mesa duket, nuk është gjithçka pasarella dhe fotografia!

Si është të jesh vajza e një ish-politikaneje dhe të

ekspozohesh tepër ndaj mediave rozë?

Mendoj se të qenit fëmijë i një politikaneje të ndihmon të proklamohesh fillimisht pasi politikanët janë qendra e vëmendjes publike, por njëkohësisht të dëmton pasi njerëzit janë kaq shumë të indoktrinuar, sa që e lidhin simpatinë e tyre njerëzore e artistike me atë politike.

Ju bezzdis vëmendja e tepërt?

Modelingu kuptohet se shoqërohet me vëmendje, shpeshherë ndoshta me tepëri. Personalisht nuk ndjehem as e mikluar dhe as e bezzdisur. Në ndonjë rast mundohem ta kaloj e menaxhoj me qetësi.

Cili ka qenë rasti që keni pasur “konflikt” me median në nxjerrjen e ndonjë lajmi të rremë?

Në eksperiencën time modeste me median kam raporte shumë të mira. Median e dua dhe prandaj zgjedha të ndjek studimet e larta në degën e gazetarisë. Si kushdo dhe unë kam përjetuar deformime apo, siç thoni ju, “konflikt”. P.sh pak kohë më parë në media u shpërnda një lajm që për momentin tronditi të afërm dhe miq të mi dhe të familjes. Titulli i lajmit ishte “Zhduket vajza modele e ish-deputetes së PD-së”. Në fakt, në brendësi nuk flitej për zhdukje reale, por për largimin tim të përkohshëm nga “Instagrami” për shkak të angazhimeve të mia shkollore. Këto lajme janë deri diku të pranueshme. Nuk ndodhin vetëm tek ne. Tashmë janë rutinë e



e madhe, është strikte për veshjet e mia

duhet të adaptohem me realitetin.

Si nisi rruga e modelingu? Kush ju ndihmoi të hidhni hapat e parë?

Modelingu e kam pasion që më ka shoqëruar qysh në fëmijëri. Besoj se është ëndrra e çdo vajze në moshë të mitur. Është një formë loje, e cila tek unë u rrit ngadalë dhe u materializua. Besoj se kam kaluar modestisht, por me siguri disa etapa fillestare. Dua të sqaroj se modelingu tek unë nuk është "fiction", por mundohem të ngjitem brenda mundësive dhe kontekstit sa më lart. Më duhet t'i shpreh mirënjohje familjes (sidomos mamit) që i kam pasur gjithmonë suport.

Të kemi parë që je imazh i disa veshjeve për nuse. Keni nisur ndonjë bashkëpunim të rëndësishëm ku mund të të shohim së shpejti?

Është e vërtetë që kam puzuar për një shtëpi veshje për nuse. Tani po bashkëpunoj në dy projekte me produktive dhe afatgjatë, të cilat për momentin nuk dëshiroj t'i ekspozoj. Në një të ardhme jo aq të largët besoj se dhe publiku do njihet me to!

Po propozime nga fotograf apo shtëpi mode të huaja keni pasur?

Për momentin përkushtimi im primar janë studimet universitare në gazetari. Për të mos qenë aq tepër modeste besoj të kem një bashkëpunim jo të largët me një fotograf në SHBA. Është një

emër tepër i njohur në këtë fushë për publikun shqiptar. Edhe pse ndoshta nënkuptohet, nuk dëshiroj ta ekspozoj. Ajo që mund të them se fotografi është një i njohur i njerëzve pranë familjes sime, të cilët kanë bërë intervenimin dhe rekomandimin fillestar.

Si ja keni dalë deri tani t'i shmangeni skandalëve?

Edukimi im familjar e social si dhe mjedisi ku jam rritur besoj janë mburoja që unë të mos bëhem viktimë e skandaleve. Shpeshherë skandalët stimulohen për të krijuar vëmendje të pamërituar. Unë kam qëllim të bëj progres në këtë rrugë delicate dhe të zoshme vetëm me punë, vullnet e sinjeritet me ato mundësi natyrale e njerëzore që me ka dhuruar Zoti.

Sa ju paguanj në modeling?

Modelingu në Shqipëri është më tepër një veprimtari pasioni sesa pagese. Këtu është një treg supermodest dhe nuk konsiderohet e vlerësohet, siç duhet problemi financiar. Gjithsesi, edhe pse nuk jam natyrë materialiste në projektet e ardhshëm do ta kem parasysh pagesën.

Cila është pika jote e dobët gjatë pozimit në fotoshooting dhe si ia arrin ta mposhtë atë?

Emocioni është kudo shoqëruar në fotoshooting. Ka dhe faktorë të tjerë si vë-



mendja e njerëzve kur pozon e fotografohesh në publik. Por unë nga natyra jam shumë e çiltër dhe sociale ndaj dhe mundohem t'i shmang emocionet me natyrshmerinë e përditshme.

Në një intervistë të mëparshme thatë se mami është strikte në veshjet tuaja. Ju jeni një modele tepër simpatike dhe jeni 'e detyruar', pavarësisht dëshirës, të vishni veshje të ekzagjeruara edhe t'i postoni ato. Ka pasur raste kur ju ka bërë titur mami dhe jeni detyruar të fshini ndonjë foto?

Është e vërtetë që mami, përveçse mbështetësa ime themelore, është dhe kritizëria më e madhe. Ajo ka një mendësi të avancuar, por më duhet të them se nuk e tejkalon momentin klasik. Në disa raste aspak të ekzagjeruara, por deri diku të avancuara, jam munduar t'ia shpjegoj e ta marrë me të mirë...haha. Gjithsesi, më duhet të them se nuk jam as vetë e prirur nga ekstravaganca e tepërt. Kam bindjen se suksesi nuk vjen nga ko-

pjimi i realiteteve të tjera, por nga harmonizimi i kontekstit kohor e shoqëror me atë që është e logjikshme dhe natyrale. Kësaj filozofie të thjeshtë besoj t'i qëndroj stoice gjatë gjithë karrierës e udhëtimit tim në këtë fushë.

A është dikush i rëndësishëm në jetën tënde, a ka të dashur Ada?

Njerëzit më të rëndësishëm për mua sot dhe përgjithmonë ngelen prindërit, vëllai Xhoni e motra Alisa. Nuk kam të dashur, ndonëse jam natyrë tepër e hapur e miqësore. Të ardhmen nuk e parashoh, por aktualisht kam prioritet studimet dhe këtë rrugë që kam nisur.

A ke pasur ndonjë propozim të pozosh nudo apo me të brendshme, në ndonjë set provokues?

Nuk kam propozime të tilla për pozime nudo apo provokuese të ekzagjeruara. Por edhe nëse do të ketë në të ardhmen do t'i refuzoj.

Në një intervistë të mëparshme ke thënë që do të jesh pjesë e kastit të "Victoria Secret". Do pra-

noje të sakrifikojë gjithçka, edhe nderin tënd për të qenë pjesë e tyre duke qenë se e ke ëndërr?

Si çdo modele dhe unë kam ëndrrat e mia. Kam parasysh, gjithashtu, eksperiencat e të tjerëve dhe vështrësinë e ngjijtes, por kurrë nuk do të sakrifikojë nderin tim për asnjë lloj çmimi e karriere. Unë ëndërrat i kam tokësore dhe mundohem t'i materializoj me punë e vullnet brenda limiteve e arsyes të karakterit me të cilin jam brumosur.

Nëse do të vinte një pikë që do të hiqnit dorë nga modelingu, nga se do të ishte?


Modelingu për mua është pasion. Dhe nuk mendoj se ka pasione të përjetshme. Jeta është e gjatë dhe me të panjohura e rastësi e shpesh dhe surprizante. Gjithashtu, dihet që modeling ka dhe disa kufij kohorë që lidhen dhe me moshën. Kështu që mendoj se e ardhmja ime do të jetë bota e gazetarisë televizive, natyrisht e lidhur ngushtë me këtë fushë.

HABIT ADELINA TAHIRI

Këngëtarja, me këpucë “Yves Saint Laurent” 10 mijë dollarë



Nuk është sekret që yjet tona po ndjekin trendet botërore. Por, shpenzimeve të mijëra eurove në klipin e fundit, Adelina Tahiri u ka shtuar një shpenzim tjetër. Ajo ka publikuar imazhe në “Inststory”, ku ka shfaqur këpucët e reja të “Yves Saint Laurent”, që kushtojnë 10 mijë dollarë. Me paraqitjen me këpucë të tillë tërhoqi vëmendjen Kendall Jenner, bukuroshja e cila u shfaq e para me këto këpucë në një ndeshje basketbolli. Adelina Tahiri shpenzoi shumë në klipin e fundit “S’je normal”. Shuma llogaritet të jetë afro 20 mijë euro, në çanta të brendeve si “Louis Vuitton”, “Gucci” dhe “Hermes”. Ajo vazhdon të jetë single dhe pa të dashur.



Ilda Bejleri flet për të dashurin: Ka gjëra më të rëndësishme se profesioni

Trajneri i ri i kombëtares, Christian Panuçi duket se nuk është i reptë vetëm me lojtarët, por edhe me gazetarët. Këtë e ka konfirmuar Ilda Bejleri, teksa ka folur për takimin e parë që kishte pasur me trajnerin kuqezi, bashkë me kolegë të tjerë. Por pavarësisht kësaj, duket se Panuçi i ka shkelur rregullat, pasi siç tregon edhe vetë Ilda, “nuk lejoheshin fotot”, por për moderatoren bukuroshe të “Supersport”, natyrshëm që do kishte përjashtim. Gjatë emisionit ajo ka thënë edhe një detaj të rëndësishëm për jetën e saj, i dashuri i saj nuk duhet të jetë patjetër futbollist. “Ka gjëra më të rëndësishme se sa profesioni”, tha ajo.



Modelja shqiptare, shtatzënë për herë të dytë

Emina Cunmulaj publikon foton

Modelja me famë botërore me origjinë shqiptare, Emina Cunmulaj ka dhënë lajmin e bukur në rrjetet sociale se është në pritje të fëmijës së saj të dytë. Ajo ka publikuar një foto në të cilën shfaqet së bashku me bashkëshortin e saj dhe vajzën Ella Faria, ndërkohë që i duket dhe barku i rrumbullakosur. Nuk dihet sa muajshe është Emina, por siç duket nga barku dhe nga fakti që e ka bërë të ditur lajmin, duhet të ketë kaluar 3-mujorin e parë. “Familja jonë po shtohet”, - ka shkruar Emina krahas fotos së publikuar. Nuk dihet ende gjinia e bebit, por Ella Faria do ta bëhet së shpejti me një motër ose vëlla.



PËRFUNDIMISHT TË NDARË


Moderatorja e njohur i jep fund martesës me partnerin

Ditët e fundit ka qenë pothuajse gjithmonë në qendër të vëmendjes çifti i njohur dhe i dashur i medias rozë. Shkak për këtë është bëtë sërish lidhja e tyre. Po flasim për çiftin Bora Zemani dhe Vin Veli. Mendohet se çifti i ka dhënë fundi lidhjes, ndërkohë që asnjëri prej të dyve nuk është shprehur rreth një fakti të tillë. Madje, para disa javësh gazetaria sportive Bora Zemani ka publikuar në rrjete sociale një foto mjaft provokuese dhe krahas saj shkruan: "Duhet të iki apo të qëndroj". Ende nuk dihet saktësisht se çfarë bëhet me çiftin. Ndërkohë që kur i është bërë një pyetje e tillë Borës, ajo nuk ka ngurrur ta përgënjeshtrojë, kur ka qenë e ftuar

në një emision para dy muajsh.

"Nuk ka asnjë të vërtetë në të gjithë këtë histori. Vini kishte shkarkuar një program për "Instagram"-in, që më fshiu mua, por edhe njerëz të tjerë si DJ Sardi, nuk e kuptoj përse njerëzit u morën vetëm me mua", - u shpreh duke qeshur Zemani. Megjithatë, ajo theksoi se duke pasur një familje dhe jo thjesht një lidhje, asaj nuk i vjen aspak mirë që diskutohen gjëra të tilla. "Dhe nuk më vjen mirë që njerëz që neve na njohin, na shohin në rrugë bashkë dhe habiten dhe thonë: Nuk qenkan ndarë", - u shpreh moderatorja e emisionit "Guximtarët" dhe "Bar Skedina".

Por mesa duket, ende qarkullon lajmi i kësaj ndarjeje sepse parvësisht se kanë kaluar dy muaj, ata ende nuk e ndjekin njëritjetrin dhe jo vetëm kaq, por nuk kanë postuar asnjë foto të përbashkët siç kishin më parë dhe gjithashtu kanë fshirë edhe ato të mëparshmet. Çifti ka një djalë të bukur të quajtur Arbor, ndërkohë që prej kohësh tashmë Bora dhe Vini nuk jetojnë më bashkë. Lajmi është konfirmuar nga miq të tyre të përbashkët, vështirë do ta kenë të justifikohen publikisht. Edhe pse ende shpresojmë për një rikthim të familjes.



Bleona provokon nga shtrati: Ja si do ta doja mashkullin ideal



Nuk ngel asnjëherë "bosh" me një këngëtare si ajo. Jo vetëm për shkak të dëshirës së madhe për të bërë famë dhe për të qenë në qendër të vëmendjes, dhe për këto sajton ndonjë gjë të veçantë sa herë të mundet, por edhe për shkak të linjave të saj fantastike dhe fotove që poston. Kësaj radhe këngëtarja e njohur, Bleona Qereti ka publikuar në faqen e saj në "Instagram" një foto në të cilën shfaqet me mëngjesin në shtrat, ndërkohë që krahas fotos ka shkruar: "Ajo që dua është një mashkull të më përmbushë çdo nevojë dhe ajo që ai do është një grua që t'i plotësojë çdo nevojë... rezultati? Mëngjesi në shtrat vetëm", - përfundon Bleona duke nënkuptuar, që nuk e ka gjetur ende mashkullin e ëndrrave të saj dhe nuk ka ngurrur t'i paraprijë kërkesat për një mashkull ideal për Bleonën. Kështu që ç'prisni? Plotësoni kërkesat!



EKSPOZITA

Endri Dani

Artizanët, nga animal laborans te homo faber

Fatmira Nikolli

Statusi i ri i homo faber' dhe tejkalimi i gjendjes së animal laborans' - që për të huazuar termin e famshëm të Hannah Arendt (2001) - kryhet nëpërmjet një procesi që shënon rënie të prodhimit në dobi të realizimit të një dimensionit të ri human, atë të rizbulimit të njeriu "artizan" (R. Sennett, 2008) i aftë për të mësuar nga gabimet dhe tensionet e vazhdueshme drejt përsosjes së gjeve krijuara.

Koncepti kuratorial i ekspozitës "Copper" (Bakri) të artistit shqiptar Endri Dani (celur në Milano) nis nga jeta e përditshme për të rrokur më pas koncepte filozofike, që i shkojnë për shtat një udhëtimi të vështirë të njeriut (të ri) në Shqipëri. Bëhet fjalë për dy kohë që shënojnë në mënyrë të pashlyeshme jetët njerëzore në vendin ku humanët u "normalizuan me të pamendueshmen" në vështirësinë e papërbalueshme të qenies. Endri Dani e nis nga një histori familjare kërkimin e tij artistik.

Ai evokon në një farë mënyrë jetën personale dhe familjare. Shkas janë bërë vitet e fëmijërisë. Mbanje mend ecejaket e nënës së tij dhe të shumë punëtorëve si ajo, artizanë, gra e burra të lirë (?) që qenë përfshirë disi në prodhimet artizanale të punishteve shtetërore të kohës, që prodhohin për llogari të Republikës Popullore. Nis aty kërkimi artistik që mbërrin në ditët tona, format e kahershme dhe gjurmët e sotme, punishtet e shkatërruara që u "rindërtuan" në forma të tjera, duke ruajtur disi traditën, por tani më në një formë të re, e me njerëz të lirë, të lirë në liri.

EKSPOZITA

Artisti shqiptar Endri Dani ka celur në Milano ekspozitën e tij personale "Copper". Kuruar nga Roberto Lacarbonara, ajo është inauguruar të martën, më 28 nëntor dhe mund të vizitohet deri më 20 janar. Bakri është lënda e parë e përdorur gjatë mijëveçarëve për të prodhuar sasi të mëdha zejtarish për përdorim shtëpiak dekorativ.

Minerali i çmuar është përdorur për një sërë aktivitetesh në zonën e Ballkanit (gjurmët e para datojnë në epokën ilire, shekujt VI-V. Para Krishtit). Zhvillimi i shpejtë i industrisë shqiptare, në fillim të shekullit të njëzetë, kishte imponuar një përpjekje të proceseve të prodhimit, me rritjen e komercializimit dhe eksportit të produkteve të bakrit, duke përfshirë "filigranët" tradicionale, objektet zburuese a bizuteritë e dala nga gërrshetimi me pjesëve të salduara dhe filave të holla metalike. Shpërndarja e gjerë e gotave prej bakri i shpërndarë me filigran, kryesisht për tregun perëndimor evropian dhe aziatik, iu nënshtrua humbjeve drastike në fillim të viteve '90, me rënien e diktaturës komuniste dhe shkatërrimin e fabrikave shtetërore. Në konceptin kuratorial shënohet se kjo nënkupton braktisjen e papritur të aktiviteteve prodhuese dhe papunësinë masive të punëtorëve. Brenda pak vitesh, megjithatë, forma të reja të artizanëve, më parë të përfshirë në industrinë e përpunimit të bakrit kanë filluar të organizohen në mënyrë të pavarur, duke blerë sasi të vogla të lëndëve të para nga fabrikat franceze dhe gjermane. Dalëngadalë, veprimtaria prodhuese vazhdon kundër dhe saj në një formë krejtësisht të re: sasi të mëdha telash elektrikë digjen në furra. Fijet e marra shtypen dhe pastaj lakohen sipas përdorimeve dhe modeleve tradicionale.

"Copper" (Bakri), ekspozita e parë personale në Itali e Endri Danit tregon historinë e kësaj metamorfoze të pazakontë të proceseve prodhuese të modernitetit. Një rrefim nga modeli industrial në atë artizanal; rilindja e ngadalë

"Copper", ekspozita personale në Milano e artistit shqiptar

dhe e nevojshme e një pune që vazhdimisht mund të rilindë dijen dhe identitetin. Mbyllja e papritur e fabrikave solli një farë zgjuarsie e kthim drejt individualitetit, çka kaloi së pari në

një gjendje depersonalizimi dhe tjetërsimi në favor të një vetëdijeje të papritur dhe një fryme të re të organizimit kolektiv. Ekspozita tregon procesin nga fillimi i punës derisa merr pamjen e një shiriti të hollë, ndërsa në mure ekspozohen copat e argjilës së papërpunuar në të cilën mund të shihen modellet dekorative të artefakteve.

Nëpërmjet ekspozimit të përcjellësve elektrikë, të vënë në atë mënyrë që të marrin lëndën e parë për përpunimin e filigranit, Endri Dani tregon udhëtimin e bakrit, nga industrinë frankogjermane në punishtet e artizanëve shqiptarë. Zgjedhja për të mos ekspozuar drejtpërdrejt objektet që tregtohen në fund, thekson ndarjen mes zburimeve/sipërfaqes, objekteve dhe mallrave: një vijë që dallon/ndan procesin industrial nga urreësia e shpikjes dhe gjetet e paçmueshme të mençurisë.

Endri Dani (1987) është diplomuar në Akademinë e Arteve në Tiranë. Praktika e tij përfshin medime të ndryshme dhe është e lidhur ngushtë me vendin ai ku jeton me historinë, subjektet dhe objektet e tij. Nuk është herë e parë, që ai shihet me një sy tjetër të shkuarën. 182 cm është projekti fotografik që artisti e ka



Artisti Endri Dani



Imazhe nga ekspozita e Danit

ekspozuar edhe më parë në "Onufri 2014". Cikli i fotografive është një 'dokumentar', i cili fokusohet në marrëdhënien e njeriut me arkitekturën. Ky projekt e çon artistin në 6 qytete të Shqipërisë në Shkodër, Pogradec, Korçë, Lezhë dhe Tiranë në kërkim të blloqeve të banimit të ndërtuara në periudhën e komunizmit. Të larta sa vetë artisti, 182 cm hyrjet e pallateve dokumentojnë standardin e një sistemi politik, që duket se nuk ka qenë kurrë në gjendje të kuptojë 'lartësinë' e vërtetë të njerëzve, të cilët ka udhëhequr për 50 vite. Me këtë projekt, ai këtë vit tërhoqi vëmendjen e revistës ndërkombëtare të arkitekturës, "Detail". Ai ka marrë pjesë po ashtu në edicionin e tretë të Kochi-Muziris Biennale, event i njohur i artit bashkëkohor zhvillohet në një nga metropolet moderne/kozopolite të Kochi-t, Indi. Dani në fillim të këtij viti, ekspozoi në Mexico City videoinstalacionin "Souvenir of my homeland".

Veç Indisë, përmendim pjesëmarrjet e Danit në Bienale si Fin del Mundo apo Marrakech Biennial. Punët e tij gjithashtu janë ekspozuar edhe në muze të artit bashkëkohor si qendra Pompidou dhe MuCem në Francë, Ludvig Museum në Budapest apo Muzeu Historik Kombëtar në Tiranë si dhe ka marrë pjesë në projekte të ndryshme në Itali, Nju Jork, Toronto, Berlin, Jeruzalem apo Los Angeles.

"MINORITETET, SHQIPËRIA RAST PËR T'U MARRË SHEMBULL PËR TRAJTIMIN"



se shtetet e tjera kriteret bazë për minoritetet, ndërsa vetë ka pësuar më shumë dëme duke ditur se ka pasur dhe minoritet shtetërore në shtetet e tjera, por që të drejtat e tyre nuk janë respektuar. Nga ana e saj, prof. asoc. dr. Sonila Boçi u shpreh se e ka pasur të vështirë për të shkruar një libër të tillë me një temë të nxehtë, siç është ai i minoriteteve. Studiuësja shpjegoi se e kish të nisur punën e saj prej viteve të Luftës së

Dytë Botërore, sepse sipas saj, prej këtej u shtruan edhe shinat që do të vazhdonin të zgateshin më tej në ruajtjen e identitetit kombëtar të pakicave. Sonila Boçi tha se të paktën minoriteti grek, si më i madhi në Shqipëri ka qenë i përfshirë në të gjitha strukturat e partisë dhe të shtetit shqiptar gjatë periudhës së komunizmit dhe se vetë pushteti komunist u tregua i kujdesshëm për ta mbajtur atë të qetë. Gjithashtu, edhe minoriteti maqedonas ka pasur të njëjtin fat dhe se këtyre minoriteteve në territorin shqiptar nuk i ka munguar as mësimi i gjuhës amtare dhe as përfshirja në strukturat drejtuese të shtetit. Në përfundim të fjalës së saj, prof. asoc. dr. Sonila Boçi tha se minoritetet në Shqipëri kanë pasur hapësirat e duhura dhe se vetë Shqipëria është një rast për t'u marrë shembull për trajtimin e minoriteteve.

Takimi u shoqërua dhe me leximin e disa pjesëve pikante të librit studimor "Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritit 1939-1949".

Jemi një komb që dimë të respektojmë pakicat". Në këtë përfundim ka dalë Sonila Boçi, autore e vëllimit studimor "Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritit 1939-1949", e cila u mbështet në argumentin e saj edhe nga drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi

"Klubi i leximit pranë muzeut" solli këtë javë studiuësën Sonila Boçi me librin "Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritit 1939-1949". Në këtë takim organizuar në sallën "Shpataraku" të Muzeut Historik Kombëtar merrnin pjesë edhe përfaqësues nga Qendra e Studimeve Albanologjike e Instituti i Historisë. "Klubi i leximit pranë muzeut" është logjoja e veprimtarive periodike javore, që po zhvillohen në Muzeun Historik Kombëtar, e cila mbështet gjithashtu fushatën kombëtare të leximit "Takohemi për një Libër" inicuar nga Ministria e Kulturës.

Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, dr. Dorian Koçi në çelje të kësaj veprimtarie tha se minoritetet duhen parë si ura bashkëpunimi mes popujve dhe jo si kuaj troje për të sjellë përçarjen mes tyre. Dr. Dorian Koçi shprehu vlerësimin e tij për studimin në fjalë tha më tej se është Shqipëria, ajo që ka respektuar më shumë

Sytë e të gjithë botës ishin drejtuar në Pallatin Shtetëror të Kremilit në Moskë, ku u hodh shorti për fazën finale të Kupës së Botës "Rusi 2018". Në një spektakël të mirëfilltë, organizatorët kishin zgjedhur Geri Linekerin si prezantues i momentit final, ku 32 ekipet e kualifikuara njohën rivalët e tyre. Skuadrat e kualifikuara ishin grupuar fillimisht në 4 vazo



Hidhet shorti i Kupës së Botës "Rusi 2018"

Rusisë "karamelë", grupet D dhe E më të fortat

prej ku u ndanë në 8 grupe, ndërsa përjashtimi i vetëm ishte Rusia, që si vend organizator u pozicionua në grupin e parë, ndërsa do ta ndajë fazën e parë të Botërorit bashkë me Arabinë Saudite, Egjiptin dhe Uruguain. Dy superfuqitë iberike, Portugalia dhe

Spanja, u shortuan në grupin e dytë së bashku me Marokun dhe Iranin. Në grupin C, Franca si kokë grupi do të ndeshet me Australinë, Perunë dhe Danimarkën; ndërsa grupi D ishte padyshim nga më të fortët që prodhuan gollat në Kremlin. Argjentina, Islan-

da, Kroacia dhe Nigeria vërtet që do ta ndezin këtë grup. Edhe grupi E është mjaft interesant. Brazili dhe Zvicrës u shtohet Serbia në luftën për një nga dy vendet që të kualifikojnë më tej, ndërsa Kosta Rika nuk është aspak për t'u nënvlerësuar. Kampionja e botës,

Gjermania, u shortua në grupin F, së bashku me Meksikën, Suedinë dhe Korenë e Jugut. Dy ekipet evropiane në grupin G, Belgjika dhe Anglia, duket se nuk do të kenë vështirësi me Panamanë dhe Tunizinë, ndërsa grupi i fundit, ai H, u formua nga Polonia, Senegali, Kolumbia dhe Japonia. Kupa e Botës do të nisë më 14 qershor, ndërsa finalja do të luhet më 15 korrik në Moskë.

Federata e paaftë të shtyjë kampionatin, shkak nisja me vonesë e veprimtarisë

Përmbytjet, FSHF vendos: Superliga luhet

Shtyhen të gjitha kategoritë, veç asaj Superiore



Jeter Selimi

Moti i keq me reshje të dendura shiu në të gjithë vendin bllokoi pjesërisht edhe futbollin shqiptar. Java e 13-të e Kategorisë Superiore do të luhet në tri ditë dhe jo në dy, siç ishte parashikuar fillimisht, sepse sfida Luftëtari-Flamurtari është shtyrë për të hënë në orën 13:00. Kjo sfidë ishte planifikuar për t'u luajtur të shtunën në këtë orar, por reshjet e dendura të ditëve të fundit e bëjnë të pamundur zhvillimin e sfidës. Ndërkohë, të shtunën ndeshja Teuta-Kamza do të luhet rregullisht, por në orën 14:00, ndërsa supersfida Skënderbeu-Kukësi nuk ka ndryshime, skuadrat do të zbrisin në fushë të shtunën në orën 17:00. Nuk ka ndryshime as për u përket ndeshjeve të së dielës me Partizanin që do të vizitojë stadiumin "Roza Haxhiu" të Lushnjës në orën 13:00 dhe në po të njëjtin orar do të luhet edhe takimi Vllaznia-Laçi. Përsa i përket Kategorisë së Parë dhe të gjitha kategorive të tjera inferiore, por edhe garës së moshave, të gjitha ndeshjet e kësaj fundjave janë shtyrë dhe do të luhen në një datë tjetër.

NJOFTIMI
"Federata Shqiptare e Futbollit, pas rakordimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me klubet vendosi që ndeshjet e kësaj jave (Java e 13-të), të Kategorisë Superiore të luhen normalisht këtë fundjavë, sipas kalendarit të shpallur, përveç ndeshjes Luftëtari-Flamurtari, e cila është spostuar për t'u luajtur ditën e hënë, datë 4 dhjetor, pasi fusha e stadiumit të Gjirokastrës nuk garanton zhvillimin normal të ndeshjes. Ky vendim erdhi si rrjedhojë e ngjeshjes së kalendarit të Kategorisë Superiore, rakordimit absolut me klubet dhe me kushtet aktuale optimale që garantojnë impiantet e skuadrave të Superiores. Ndërkohë, të gjitha kampionatet e tjera duke pasur infrastrukturën, e cila në kushte atmosferike të rënduara nuk garanton zhvillimin normal të

SUPERLIGA	
JAVA E 13	
TË SHTUNËN	
Teuta-Kamza	14:00
Skënderbeu-Kukësi	17:00
TË DIEËN	
Vllaznia-Laçi	13:00
Lushnja-Partizani	13:00
TË HËNË	
Luftëtari-Flamurtari	13:00

ndeshjeve janë shtyrë për javën e ardhshme".

A MUND TË SHMANGEJ?

Por a mund të shmangej kjo situatë? Natyrisht që po, sikundër ndodhi me kategoritë inferiore, edhe Superliga mund të zhvendosej për një ditë tjetër, pa cenuar klubet dhe mbi të gjitha tifozët



që udhëtojnë për të mbështetur ekipet e tyre të zemrës. Gjithçka lidhet me vendim absurd në verë për ta nisur kampionatin në shtator, duke u bërë vendi i fundit në Europë që startonte

ligën e tij, me vendet e tjera që kishin minimalisht një javë kampionat të luajtur. Në një situatë të tillë, kur FSHF-ja u detyra të aplikonte një ndeshje të paplanifikuar për kalendarin e Kombëtares,

apo edhe në rastin me qesharak, kur nuk deklaroi se nuk e kishte menduar kualifikimin e Skënderbeut në grupet e Europa League, ndonëse ekipi korçar kishte arritur play-off-in.

PËRMBYTJET



Luftëtari bllokohet në liqenin e Viroit

Lojtarët e Luftëtarit nuk kanë mundur të kryejnë dje seancën e radhës. Arsyeya është se ekipi ndodhet i grumbulluar në një nga hotelet e pikës turistike të Viroit, 5 kilometra në dalje të qytetit. Mirëpo, përdje në mbrëmje liqeni i Viroit doli nga shtirë dhe ishte e pamundur që skuadra të udhëtoje nga hoteli deri në kompleksin stërvitor. "Panorama Sport" zbulon se trajneri Hasan Lika vendosi që të evitonte aventura me makina dhe kësaj Luftëtari sot nuk u stërvit fare në prag të ndeshjes me Flamurtarin, që u shty për të hënë.

Disiplina dënoi me 4 ndeshje parullën e pulave në Vlorë!

Gurët ndaj tifozëve të Kukësit, FSHF dënon me dy ndeshje Laçin



Tiranës. Në këtë mënyrë, Laçi do t'i luajë ndeshjet e kampionatit kundër Skënderbeut dhe Lushnjës me dyer të mbyllura. Në sfidën Laçi-Kukësi u regjistruan dy episode të tension-

uara, ku tifozët mbështetës të skuadrës vendosë goditën me mjete të forta lojtarët e Kukësit, Kale dhe Idrizi, ndërsa në përfundim të ndeshjes u regjistruan edhe përplasjet e dhunshme mes tifozërve të të dyja ekipeve. Gjithsesi, është mjaft qesharak fakti që pak javë më parë klubi i Flamurtarit u dënua nga po ky komision me 4 ndeshje pa tifozë për shkak të parullës së famshme të pulave, ndërsa atje ku u rrezikua jeta e tifozëve, FSHF jep vetëm gysmën e dënimit.


ËNDËRROHET BRAZILIANI

Barcelona bën gati çekun 145-milionësh për Kutinjon

Felipe Kutinjo vazhdon të jetë objektivi kryesor i Barcelonës në merkato. Futbollisti brazilian nuk mundi që të kompletonte transferimin në "Kamp Nou", pasi drejtuesit e Liverpoolit nuk pranuan ofertën e katalanasve. "Sport" dhe "Mundo Deportivo" shkruajnë se Barcelona do të shpenzojë për të 145 milionë euro, ndërkohë që për futbollistin pritet që të bëhet gati kontrata me 14 milionë euro në sezon. Braziliani shihet si zëvendësuesi ideal i Nejmari, pavarësisht faktit se gjatë verës u ble Dembele, i cili u dëmtua. Operacioni mund të finalizohet me sukses gjatë janarit, duke parë edhe dëshirën e lojtarit, i cili nuk po shkëlqen në këtë sezon të ri me klubin anglez.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Emri i Monet.
8. Një top në rrjetë.
11. Carl Edward, që shkroi Contact.
12. Qe bukuroshi që u hidhte ferë perëndive.
15. Qe era hynore e japonezeve.
16. Një pjesë e lartësive.
18. Muzikanti që... nuk përsëriste.
20. Lumë në Rusi.
21. Eshhtë i lartë ai i kampionit.
22. Kailifi që themeloi Kairon.
24. Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
25. Janë në guvë.
26. Ilioni portier.
27. Markë makine.
28. Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
29. Inicialet e Mann.
30. Një parabolë e tenisit.
31. Fillojnë tatepjeten.
32. Ente Autonome.

VERTIKAL

1. Inicialet e Santana-s, kitarist.
2. Nota e diapazonit.
3. Eshhtë frika nga shehet e hapura.
4. Diftong në duar.
5. Duhën në ekstreme.
6. Qe libri erotik i Mallanaga Yatsayana-s.
7. Lauda ish-pilot i Formula 1.
8. Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
9. Një poemë.
10. Fund tuneli.
12. Një eleganat si Aramis.
13. Qe kryeqyteti i Asirisë.
14. Qe toreador i famshëm.
15. Urdhëroi sakrifikimin e Ifigenias.
16. Eshhtë pushteti i... bashkisë.
17. Qe lumi i Karontit.
18. Inicialet e Klee piktor.
19. Ishite gjuha e Jezu Krishtit.
23. U shndërrua në dre nga Afërdita.
28. Rex i Nero Wolfe.
35. Nino, kompozitor i njohur.
36. Një... story e John Le Carré.
38. Shkroi Tregime të jshhtëzakonshme.
41. Kufizojnë një sektor.
42. Inicialet e Einstein.
43. Inicialet e Matthieu, këngëtare.
44. Kufizojnë sportet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Lindi Isakun.
3. Në krye të bashkisë.
5. Në djep kur nuk... je.
7. Nota e diapazonit.
9. Emri i parë i Erasmit të Rotterdemit.
12. Mbyllin akte.
14. Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
15. Diku në qendër.
16. Rrallë është përgjysmë.
17. Bëri edhe Madame Butterfly.
18. Norman, psikopati te Psycho.
19. Të parat në sjellje.
20. Vret me një re.
21. Gjarpri që u vra nga Apolloni.
24. Lindi Perseun.
26. Besniku mesfushor
27. Ai i vajtitit është në Jerusalem.
29. Carol, aktore.
30. Në krye të subjekteve.

VERTIKAL


1. Ishte sundimtari i provincave perseisha.
2. Inicialet e Duvall
3. Oytei i njembjësitarve.
4. Ishin armiqetë babilonasve.
5. Shkroi Jacuqes le fataliste
6. Eshhtë edhe tendencë.
7. Joan i interpretuar nga Celentano.
8. Jetojnë në vetmi.
9. U soll në Europë në Jean Nicot.
10. Ai i Aida-s është Radames.
11. Një ishte edhe Deceballi.
13. Inicialet e Rohmer regjisor.
18. Titulli i Bruce Springsteen.
20. Hidhet një me... kërcim.
22. U shkrua nga Camus.
23. Fillojnë takimin.
25. Fillojnë natën.
27. Pierce teniste.
28. Grisur pa gur.
31. Fillojnë panikun.
32. Shijuar pa shuar.
34. Fleming, që krijoi James Bond.
35. Kështu merr ai që... mbaron.
36. Mbajtësja e topit në golf.
37. Ekstreme për gotik.
38. Carson i funnneti-t.
40. Një padi kur s'është ai.
41. Bëhen arianë me një anë.
42. Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
43. Bëhet nuse me ne.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

8	7			2	6
		9	3	4	
4	6	7			5
	8		9	4	1
		5	2	1	7
4	2	3	6		9
5				9	7
	4		5	8	
2	3		9		8

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	1	2	3	5	9	7	6	4
5	6	3	7	8	4	2	1	9
9	4	7	6	2	1	5	3	8
4	7	1	2	3	8	6	9	5
2	3	9	4	6	5	1	8	7
6	8	5	1	9	7	3	4	2
1	9	8	5	7	6	4	2	3
3	5	4	9	1	2	8	7	6
7	2	6	8	4	3	9	5	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9


Argëtim filozofik

- Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj reziqeve do të kultivojë forcën e regjimit ndaj tyre. (Seneka)
- Arti i krijimit është më i vjetër se sa arti i vrasjes. (Andrej Voznjezenski)
- Asnjë artist nuk ec para kohës së tij. Ai është vetë koha e tij. Vetëm se të tjerët janë prapa kësaj kohe. (Marta Grehem)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Nuk është e vështirë të ngjitesh në majë. E vështirë është të qëndrosh gjatë atje. Claude Debussy Kompozitor (1862-1918)
- Disa vese po të përdoren mirë, shkelqejnë më shumë se viriti. La Rochefoucauld Shkrimtar (1613-1680)
- Është e preferueshme të mos bëhet një vepër e bërë keq, sepse më pas do pendohemi. Atë që bëjmë, më mirë ta bëjmë të rregullt (mirë), për të mos u penduar më pas.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

1. MONET
8. RREZETË
11. CONTACT
12. FERË
15. JAPONEZË
16. MOUNTAIN
18. MONTECARLO
20. RIVER
21. CHAMPION
22. CAIRO
24. SAINT PETER
25. GROTTO
26. PORTIER
27. MACHINE
28. WINNER
29. MANN
30. TENNIS PARABOL
31. TATEPJETEN
32. AUNT

FJALËKRYQI (2)

1. LISAKUN
3. BASHKISË
5. DJEP
7. DIAPAZONIT
9. ERASMIT
12. AKTE
14. GOMARIT
15. QENDËR
16. PËRGJYSMË
17. BUTTERFLY
18. PSYCHO
19. SJELLJE
20. RE
21. APOLLON
24. PERSEUS
26. MESFUSHOR
27. JERUSALEM
29. CAROL
30. SUBJEKTEVE

Thënie të mënçura

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

